


**RAPORTI I MONITORIMIT
TË ZBATIMIT TË DETYRIMEVE
LIGJORE TË SIGURIMIT
TË TRANSPARENCËS DHE
PROCESIT TË KONSULTIMIT
PUBLIK NGA BASHKITË**



**RAPORTI I MONITORIMIT
TË ZBATIMIT TË DETYRIMEVE
LIGJORE TË SIGURIMIT
TË TRANSPARENCËS DHE
PROCESIT TË KONSULTIMIT
PUBLIK NGA BASHKITË**



Përmbajtja

HYRJE	4	Bashkia Durrës	14
RAPORTI 2023	5	Bashkia Korçë.....	16
TRANSPARENCA	5	Bashkia Lezhë.....	17
METODOLOGJIA	5	Bashkia Shkodër	18
PARASHIKIMET LIGJORE TË INDIKATORËVE TË MONITORUAR.....	6	Bashkia Vlorë	20
GJETJET PËR SECILËN PREJ BASHKIVE.....	9	Bashkia Himarë.....	21
Bashkia Dibër	9	ANALIZË KRAHASUESE.....	23
Bashkia Elbasan	10	MONITORIMI I PREMTIMEVE	24
Bashkia Fier	12	GJETJET PËR SECILËN PREJ BASHKIVE.....	33
Bashkia Kavajë	13	FONDI SOCIAL.....	37
		ANEX 1	48

HYRJE

Projekti “40 premtime, 10 bashki” është i mbështetur nga National Endowment for Democracy (NED) dhe është implementuar nga Qendra Fakte. Synimi i këtij projekti është monitorimi i bashkive sa i përket mbajtjes së premtimeve dhe transparencës. Gjatë vitit të shkuar projekti përfshiu bashkitë e Dibrës, Lezhës, Shkodrës, Vlorës, Himarës, Durrësit, Kavajës, Fierit, Korçës, dhe Elbasanit të cilat u monitoruan nga gazetarë lokalë si edhe aktivistë të shoqërisë civile.

Metodologjia e ndjekur për implementimin e këtij projekti është e njëjtë me metodologjinë e përdorur gjatë vitit të shkuar. Për secilën nga bashkitë janë përzgjedhur 4 premtime të bëra nga kryebashkiakët aktualë gjatë fushatës elektorale për zgjedhjet vendoreve 2023. Këto premtime u monitoruan në bazë të një metodologjie analitike që përfshinte analizën buxhetore, monitorimin e prokurimit publik dhe vëzhgimet në terren. Gjithashtu raporti ka monitoruar edhe programin e transparencës, detyrim ligjor i Bashkive që rrjedh nga legjislacioni i qeverisjes vendore, legjislacioni i konsultimit publik dhe ligji për të drejtën e Informimit. Nga

ana tjetër, transparenca dhe konsultimi publik janë të rregulluara nga kuadri ligjor dhe nënligjor i Shqipërisë. Duke qenë se në bazë të legjislacionit vendas, çdo institucion publik duhet të zbatojë programin e transparencës, projekti ka monitoruar se sa ky program zbatohet nga bashkitë e përfshira në projekt.

Ky raport i rifreskuar synon që të përcjellë të dhëna lidhur me monitorimin e zbatimit të këtyre parashikimeve nga dhjetë bashki të vendit. Në raport do të gjeni metodologjinë e përdorur, gjetjet e detajuara të secilës prej bashkive dhe disa rekomandime për përmirësimin sa i përket llogaridhënies dhe zbatimit të parashikimeve ligjore në lidhje me transparencën.

Ky raport ndahet në tre kapituj. Kapitulli i parë lidhet me indeksin e transparencës. Kapitulli i dytë me mbajtjen e premtimeve nga ana e kryetarëve të bashkive kurse kapitulli i tretë lidhet me rëndësinë e Fondit Social si mekanizëm për të fuqizuar bashkitë dhe me problematikat që hasen në përthithjen e fondeve.

RAPORTI 2023


TRANSPARENCA

METODOLOGJIA

Detyrimet e njësive të vetëqeverisjes vendore që lidhen me procesin e konsultimit publik dhe zbatimin e transparencës janë identifikuar nëpërmjet analizës së kuadrit ligjor përkatës. Organizimi dhe funksionimi i njësive të vetëqeverisjes vendore është i rregulluar në Ligjin Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ndërsa detyrimet e tyre për procesin e konsultimit publik dhe zbatimin e transparencës rregullohen më tej nga Ligji Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Ligji Nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik” dhe Ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, siguron disiplinë fiskale, politika të qëndrueshme dhe transparente për menaxhimin e fondeve publike, dhe parashikimin realist të të ardhurave dhe shpenzimeve vendore.

Normativa ligjore përsa i përket transparencës në njësitë e pushtetit vendor është plotësuar më tej me Urdhërin nr. 211, dt. 20.09.2018, të Komisionerit për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale, ku përcaktohet “Programi Model i Transparencës për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore”, duke detajuar më tej detyrimet e organeve të pushtetit vendor për të siguruar transparencë dhe informim të publikut. Nga parashikimet e këtyre tre ligjeve janë gjeneruar edhe 16 indikatorët për të cilat janë monitoruar dhjetë bashkitë e vendit:

- **INDIKATORI 1:** Caktimi dhe publikimi i një personi si koordinator i njoftimit dhe konsultimit publik, i cili është përgjegjës për bashkërendimin dhe administrimin e përgjithshëm të punës për garantimin e së drejtës së njoftimit e të konsultimit publik;
- **INDIKATORI 2:** Konsultimi i buxhetit vjetor të bashkisë;
- **INDIKATORI 3:** Konsultimi i paketës së taksave dhe tarifave vendore;
- **INDIKATORI 4:** Konsultimi i tjetërsimit të pronave të bashkisë;
- **INDIKATORI 5:** Vendosja e njoftimeve për organizimin e seancave për konsultimin publik në faqen e internetit apo në stendën e njoftimeve publike të bashkisë;
- **INDIKATORI 6:** Vendosja e njoftimeve për organizimin e dëgjësive publike nga këshilli bashkiak në faqen e internetit apo në stendën e njoftimeve publike të Bashkisë;
- **INDIKATORI 7:** Njoftimi paraprakisht i datës dhe orës së mbledhjeve të këshillit bashkiak në faqen e internetit apo në stendën e njoftimeve publike të bashkisë;
- **INDIKATORI 8:** Njoftimi paraprakisht i datës dhe orës së mbledhjeve të komisioneve të këshillit bashkiak në faqen e internetit apo në stendën e njoftimeve publike të bashkisë;
- **INDIKATORI 9:** Përcaktimi dhe publikimi i të dhënave të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit;



RAPORT MONITORIMI

TRANSPARENCA E 10 BASHKIVE DHE MATJA E 40 PREMTIMEVE TË KRYEBASHKIAKVE

- **INDIKATORI 10:** Publikimi i Programit të Transparencës në faqen e internetit të bashkisë;
- **INDIKATORI 11:** Publikimi i strukturës organizative të bashkisë;
- **INDIKATORI 12:** Publikimi i buxhetit vjetor të bashkisë;
- **INDIKATORI 13:** Publikimi i vendimeve të Këshillit Bashkiak;
- **INDIKATORI 14:** Publikimi i procesverbaleve të mbledhjeve të këshillit bashkiak;
- **INDIKATORI 15:** Publikimi i urdhërave dhe vendimeve të kryetarit të bashkisë;
- **INDIKATORI 16:** Publikimi në faqen e internetit apo në stendën e njoftimeve publike i raporteve të zbatimit të buxhetit.

Të dhënat e këtij raporti për monitorimin e 16 indikatorëve janë mbledhur nga gazetarët në terren. Gazetarët zhvilluan paraprakisht takime informuese me ekspertët të cilët punuan me identifikimin e indikatorëve dhe ekspertin ligjor, për t' u informuar dhe për të marrë shpjegimet përkatëse për të gjithë indikatorët, bazën ligjore të tyre dhe mënyrën e monitorimit. Pas këtij procesi informues dhe sqarues me gazetarët, këta të fundit duke pasur informacionin e duhur mbi indikatorët, mbi parashikimet ligjore të detyrimeve të bashkive për realizimin e tyre dhe burimet nga mund të merrnin informacion për secilin prej tyre, kanë analizuar faqet zyrtare të internetit të bashkive dhe kanë monitoruar stendat e njoftimeve publike të bashkive, si një mënyrë tjetër alternative që përdorin bashkitë për komunikimin me qytetarët. Gjithashtu gazetarët kanë ndjekur drejtëpërdrejtë mbledhjet e këshillit bashkiak, fizikisht dhe/ose online sipas rasteve përkatëse. Një burim tjetër i përdorur nga gazetarët për mbledhjen e të dhënave është komunikimi i drejtëpërdrejtë me bashkinë, duke kërkuar informacion.

Përveç këtij monitorimi të gazetarëve, bashkive të monitoruara i është dërguar shkresë zyrtare duke

i kërkuar informacionin dhe dokumentacionin përkatës për indikatorët e mësipërm të cilat lidhen me konsultimin e akteve të miratuara dhe njoftimet që duhet të realizohen në kuadër të zhvillimit të konsultimit publik për to. Pavarësisht detyrimit ligjor të parashikuar në nenin 15, të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" ku parashikohet se institucionet duhet të kthejnë përgjigje brenda 10 ditëve pune nga dita e dorëzimit të kërkesës, asnjë prej bashkive nuk u përgjigj.

Për të bërë një renditje të bashkive të përfshira në projekt sa i përket transparencës, për secilin nga indikatorët e sipër-përmendur bashkive u është alokuar nga 1 pikë për një total prej 16 pikësh për bashkitë që plotësojnë të gjitha kërkesat ligjore.


PARASHIKIMET LIGJORE TË INDIKATORËVE TË MONITORUAR

Indikatorët e monitoruar për dhjetë bashkitë e vendit janë gjeneruar nga parashikimet ligjore përkatëse të cilat rregullojnë njësitë e vetëqeverisjes vendore, procesin e konsultimit publik dhe transparencën. Konkretisht janë Ligji Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Ligji Nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" dhe Ligji Nr.146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik".

Ligji Nr.146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik" rregullon procesin e konsultimit publik, për të siguruar transparencën, gjithëpërfshirjen dhe realizimin në kohë të veprimeve. Ky konsultim publik, për të siguruar përfshirjen në procesin e vendimmarrjes zhvillohet për projektakte si projektligje, dokumente strategjike kombëtare dhe lokale, si dhe politika me interes të lartë publik.

Parashikimet ligjore të parashikuara në këtë ligj, zbatim i të të cilave janë monitoruar për bashkitë janë konkretisht:

- Caktimi dhe publikimi i një personi si koordinator i njoftimit dhe konsultimit publik,



i cili është përgjegjës për bashkërendimin dhe administrimin e përgjithshëm të punës për garantimin e së drejtës së njoftimit e të konsultimit publik¹;

- Konsultimi i buxhetit vjetor të bashkisë²
- Konsultimi i paketës së taksave dhe tarifave vendore³
- Konsultimi i tjetërsimit të pronave të bashkisë⁴
- Vendosja e njoftimeve për organizimin e seancave për konsultimin publik në faqen e internetit apo në stendën e njoftimeve publike të bashkisë⁵
- Vendosja e njoftimeve për organizimin e dëgjësive publike në faqen e internetit apo në stendën e njoftimeve publike të bashkisë⁶
- Njoftimi paraprakisht i datës dhe orës së mbledhjeve të këshillit bashkiak në faqen e

internetit apo në stendën e njoftimeve publike të bashkisë⁷

- Njoftimi paraprakisht i datës dhe orës së mbledhjeve të komisioneve të këshillit bashkiak në faqen e internetit apo në stendën e njoftimeve publike të bashkisë⁸

Ligji Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike. Parashikimet ligjore të parashikuara në këtë ligj, zbatim i të cilave janë monitoruar për bashkitë janë konkretisht:

- Përcaktimi dhe publikimi i të dhënave të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit⁹
- Publikimi i Programit të Transparencës në faqen e internetit të bashkisë¹⁰
- Publikimi i strukturës organizative të bashkisë¹¹

¹ “Çdo organ publik cakton një person si koordinator të njoftimit dhe konsultimit publik, i cili është përgjegjës për bashkërendimin dhe administrimin e përgjithshëm të punës për garantimin e së drejtës së njoftimit e të konsultimit publik, të parashikuara nga ky ligj”, Neni 10, ligji Nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”

² “Ky ligj rregullon procesin e njoftimit dhe të konsultimit publik të projektligjeve, projektdokumente strategjike kombëtare dhe vendore, si dhe politikave me interes të lartë publik”, Neni 1, ligji Nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”. Detyrimi për këtë këshillim e konsultim buron edhe nga parashikimet e ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, konkretisht nenet 18 dhe 54 të këtij ligji.

³ Po aty

⁴ Po aty

⁵ “Njoftimi për projektaktet që do t’i nënshtrohen procedurës së konsultimit publik bëhet nëpërmjet regjistrit elektronik. Në rastet kur organi publik e konsideron të nevojshme, njoftimi mund të kryhet edhe në një apo disa nga format e mëposhtme: a) me postë elektronike; b) me lajmërim publik, i cili afishohet në ambientet e organit publik inicues; c) me një lajmërim në mediat audiovizive kombëtare, rajonale ose lokale; ç) me botimin në gazeta lokale ose në dy gazetat më të lexuara në nivel kombëtar. 2. Marrja e komenteve dhe rekomandimeve në procesin e konsultimit publik kryhet në një nga format e përmendura më sipër, si dhe në raste të caktuara në formë verbale dhe/ose me shkrim e të regjistruara në procesverbalin e takimeve publike”. Neni 1, ligji Nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”

⁶ Po aty


⁷ “Njoftimi për mbledhjen e këshillit bëhet publik në vende të caktuara për këtë qëllim brenda territorit të njësisë vendore dhe në media të aksesueshme në njësinë vendore dhe përmban datën, vendin, orën dhe rendin e ditës së mbledhjes”, neni 17, ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”. Përveç parashikimit në këtë ligj, dy indikatorët e fundit janë analizuar edhe në këndvështrimin e zhvillimit të konsultimit publik, ku nëpërmjet mbledhjeve të këshillit bashkiak e komisioneve, bashkia këshillohet me qytetarët

⁸ Neni 54 i ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” parashikon se Këshilli bashkiak zgjedh nga përbërja e vet komisionet e këshillit dhe miraton rregulloren e brendshme të funksionimit të vet. Komisioni si një nga strukturat e këshillit bashkiak ka të njëjtat detyrime kundrejt qytetarëve të njësisë, për më tepër që këshilli bashkiak ka për detyrë këshillimin me bashkësinë për krijimin e këtyre komisioneve sipas parashikimeve të neneve 18 dhe 54/a të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

⁹ “Për zbatimin e këtij ligji, me qëllim bashkërendimin e punës për garantimin e së drejtës së informimit, autoriteti publik cakton një prej nëpunësve si koordinator për të drejtën e informimit”, Neni 10, ligji Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”

¹⁰ “Në përputhje me programin e transparencës së miratuar për çdo autoritet publik, këto të fundit përgatitin paraprakisht, në formate lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme, si dhe vënë në dispozicion të publikut në faqen e tyre në internet kategoritë e mëposhtme të informacionit: a) një përshkrim të strukturës organizative, funksioneve dhe detyrave të autoritetit publik; b) tekstat e plota... të akteve nënligjore; e) të dhëna për buxhetin”, Neni 7, ligji Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”

¹¹ Po aty



RAPORT MONITORIMI

TRANSPARENCA E 10 BASHKIVE DHE MATJA E 40 PREMTIMEVE TË KRYEBASHKIAKVE

- Publikimi i buxhetit vjetor të bashkisë¹²
- Publikimi i vendimeve të Këshillit Bashkiak¹³
- Publikimi i procesverbaleve të mbledhjeve të këshillit bashkiak¹⁴
- Publikimi i urdhërave dhe vendimeve të kryetarit të bashkisë¹⁵

¹² Po aty

¹³ Po aty. Zbatimi i parashikimeve të ligjit Nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" referohet për detyrimin e publikimit të akteve të këshillit bashkiak drejtëpërdrejtë nga ligji nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" në nenin 18. Në këtë nen parashikohet gjithashtu se aktet e këshillit bashkiak publikohen në faqen zyrtare të internetit dhe afishohen në vende publike.












¹⁴ Po aty


¹⁵ Po aty

GJETJET PËR SECILËN PREJ BASHKIVE

BASHKIA DIBËR

Për Bashkinë Dibër janë monitoruar të gjithë indikatorët sipas metodologjisë së përshkruar më sipër dhe gjetjet e kësaj Bashkie për secilin prej këtyre indikatorëve janë si më poshtë.

Nr	Indikatori	Komente	Statusi
1	Publikimi i Programit të Transparencës në faqen e internetit të Bashkisë	Bashkia Dibër e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të Programit të Transparencës.	
2	Caktimi dhe publikimi i të dhënave për Koordinatorin e Njoftimit dhe Konsultimit Publik	Bashkia Dibër e ka realizuar detyrimin për publikimin e të dhënave të koordinitorit të konsultimit publik, pasi në faqen zyrtare të internetit ka shënuar adresën e emailit dhe të dhënat e koordinitorit.	
3	Caktimi dhe publikimi i të dhënave për Koordinatorin për të Drejtën dhe Informimin	Bashkia Dibër e ka realizuar detyrimin për caktimin dhe publikimin e të dhënave të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit.	
4	Publikimi i Strukturës Organizative të Bashkisë	Bashkia Dibër e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të strukturës organizative të bashkisë.	
5	Publikimi i buxhetit vjetor të Bashkisë	Bashkia Dibër e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të buxhetit vjetor përgjatë viteve.	
6	Vendosja e njoftimeve për organizimin e seancave për konsultimin publik në faqen e internetit apo standën e njoftimeve publike	Bashkia Dibër ka të publikuar në internet njoftime për realizimin e seancave për konsultim publik.	
7	Konsultimi publik i buxhetit vjetor të Bashkisë	Bashkia Dibër e ka konsultuar me qytetarët buxhetin vjetor të Bashkisë. Nga vëzhgimi i faqes së internetit dhe nga standat e njoftimit, janë publikuar njoftime për zhvillimin e proceseve konsultuese për buxhetin vjetor të Bashkisë.	
8	Konsultimi publik i paketës së taksave dhe tarifave vendore	Sa i përket paketës së taksave dhe tarifave vendore për periudhën 2023-2024 ato janë konsultuar me publikun njëkohësisht me buxhetin vjetor 2023, 2024 të Bashkisë Dibër. Nga vëzhgimi i faqes së internetit dhe i standave të njoftimeve janë konstatuar realizime aktivitetesh për përmbushjen e këtij detyrimi.	
9	Konsultimi publik i vendimeve për tjetërsimin e pronave të Bashkisë	Kërkesës për informacion mbi këtë çështje, bashkia iu përgjigj se nuk ka mbajtur konsultime publike, pasi për periudhën Janar 2023 - Dhjetor 2023 nuk është bërë asnjë procedurë për tjetërsim të pronave të Bashkisë Dibër.	
10	Publikimi i Urdhërave dhe Vendimeve të Kryetarit të Bashkisë	Bashkia Dibër nuk e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të urdhërave dhe vendimeve të kryetarit të bashkisë.	
11	Njoftimi i datës dhe orës së mbledhjeve të Këshillit Bashkiak në faqen e internetit apo standën e njoftimeve publike	Bashkia Dibër ka vendosur në standën e njoftimeve, njoftime paraprake lidhur me njoftimet për mbledhjet e këshillit bashkiak.	



RAPORT MONITORIMI


TRANSPARENCA E 10 BASHKIVE DHE MATJA E 40 PREMTIMEVE TË KRYEBASHKIAKVE

12	Njoftimi i datës dhe orës së mbledhjeve të komisioneve të Këshillit Bashkiak në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Dibër ka vendosur në stendat e njoftimeve dhe ka publikuar në faqen zyrtare të internetit, njoftime paraprake lidhur me njoftimet për mbledhjet e komisioneve të këshillit bashkiak.	
13	Publikimi i Proces-Verbaleve të mbledhjeve të Këshillit Bashkiak	Bashkia Dibër nuk e ka realizuar detyrimin për publikimin e procesverbaleve të mbledhjeve të këshillit bashkiak.	
14	Publikimi i Vendimeve të Këshillit Bashkiak	Bashkia Dibër e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të vendimeve të këshillit bashkiak	
15	Vendosja e njoftimeve për organizimin e dëgjësive publike nga Këshilli Bashkiak në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Dibër ka vendosur në stendat e njoftimeve dhe publikuar në faqen zyrtare të internetit, njoftime lidhur me zhvillimin e dëgjësive publike nga këshilli bashkiak.	
16	A janë publikuar në faqen e internetit apo në stendën e njoftimeve publike raporte të zbatimit të buxhetit?	Bashkia Dibër ka publikuar raporte të monitorimit të zbatimit të buxhetit.	
17	Totali i Realizimit		87.5%


BASHKIA ELBASAN

Për Bashkinë Elbasan janë monitoruar të gjithë indikatorët sipas metodologjisë së përshkruar më sipër dhe gjetjet e kësaj Bashkie për secilin prej këtyre indikatorëve janë si më poshtë.

Nr	Indikatori	Komente	Statusi
1	Publikimi i Programit të Transparencës në faqen e internetit të Bashkisë	Bashkia Elbasan e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të Programit të Transparencës.	
2	Caktimi dhe publikimi i të dhënave për Koordinatorin e Njoftimit dhe Konsultimit Publik	Bashkia Elbasan nuk e ka realizuar detyrimin për publikimin e të dhënave të koordinorit të konsultimit publik.	
3	Caktimi dhe publikimi i të dhënave për Koordinatorin për të Drejtën dhe Informimin	Bashkia Elbasan e ka realizuar detyrimin për caktimin dhe publikimin e të dhënave të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit.	
4	Publikimi i Strukturës Organizative të Bashkisë	Bashkia Elbasan e ka realizuar detyrimin për publikimin e strukturës organizative të bashkisë në faqen zyrtare të internetit.	
5	Publikimi i buxhetit vjetor të Bashkisë	Bashkia Elbasan e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të buxhetit vjetor përgjatë viteve.	
6	Vendosja e njoftimeve për organizimin e seancave për konsultimin publik në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Elbasan ka publikuar në internet njoftime për realizimin e seancave për konsultim publik.	



7	Konsultimi publik i buxhetit vjetor të Bashkisë	Bashkia Elbasan nuk e ka konsultuar me qytetarët buxhetin vjetor të Bashkisë.	
8	Konsultimi publik i paketës së taksave dhe tarifave vendore	Bashkia Elbasan nuk e ka konsultuar me qytetarët paketën e taksave dhe tarifave vendore.	
9	Konsultimi publik i vendimeve për tjetërsimin e pronave të Bashkisë	Bashkia Elbasan nuk e ka plotësuar këtë kërkesë ligjore.	
10	Publikimi i Urdhërave dhe Vendimeve të Kryetarit të Bashkisë	Bashkia Elbasan nuk e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të urdhërave dhe vendimeve të kryetarit të bashkisë.	
11	Njoftimi i datës dhe orës së mbledhjeve të Këshillit Bashkiak në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Elbasan ka vendosur në faqen e internetit, njoftime paraprake lidhur me njoftimet për mbledhjet e këshillit bashkiak.	
12	Njoftimi i datës dhe orës së mbledhjeve të komisioneve të Këshillit Bashkiak në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Elbasan ka vendosur në stendat e njoftimeve dhe ka publikuar në faqen zyrtare të internetit, njoftime paraprake lidhur me njoftimet për mbledhjet e komisioneve të këshillit bashkiak.	
13	Publikimi i Proces-Verbaleve të mbledhjeve të Këshillit Bashkiak	Bashkia Elbasan e ka realizuar detyrimin për publikimin e procesverbaleve të mbledhjeve të këshillit bashkiak.	
14	Publikimi i Vendimeve të Këshillit Bashkiak	Bashkia Elbasan e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të vendimeve të këshillit bashkiak.	
15	Vendosja e njoftimeve për organizimin e dëgjësive publike nga Këshilli Bashkiak në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Elbasan ka vendosur në stendat e njoftimeve dhe publikuar në faqen zyrtare të internetit, njoftime lidhur me zhvillimin e dëgjësive publike nga këshilli bashkiak.	
16	A janë publikuar në faqen e internetit apo në stendën e njoftimeve publike raporte të zbatimit të buxhetit?	Bashkia Elbasan nuk ka publikuar raporte mbi zbatimin e buxhetit.	
17	Totali i Realizimit		62.5%




RAPORT MONITORIMI

TRANSPARENCA E 10 BASHKIVE DHE MATJA E 40 PREMTIMEVE TË KRYEBASHKIAKVE

BASHKIA FIER

Për Bashkinë Fier janë monitoruar të gjithë indikatorët sipas metodologjisë së përshkruar më sipër dhe gjetjet e kësaj Bashkie për secilin prej këtyre indikatorëve janë si më poshtë.

Nr	Indikatori	Komente	Statusi
1	Publikimi i Programit të Transparencës në faqen e internetit të Bashkisë	Bashkia Fier e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të Programit të Transparencës.	
2	Caktimi dhe publikimi i të dhënave për Koordinatorin e Njoftimit dhe Konsultimit Publik	Bashkia Fier e ka realizuar detyrimin për publikimin e të dhënave të koordinatorit të konsultimit publik, pasi në faqen zyrtare të internetit ka shënuar adresën e emailit dhe të dhënat e koordinatorit.	
3	Caktimi dhe publikimi i të dhënave për Koordinatorin për të Drejtën dhe Informimin	Bashkia Fier e ka realizuar detyrimin për caktimin dhe publikimin e të dhënave të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit.	
4	Publikimi i Strukturës Organizative të Bashkisë	Bashkia Fier e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen e strukturës organizative të bashkisë.	
5	Publikimi i buxhetit vjetor të Bashkisë	Bashkia Fier e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të buxhetit vjetor përgjatë viteve.	
6	Vendosja e njoftimeve për organizimin e seancave për konsultimin publik në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Fier nuk ka publikuar në internet apo vënë në stendë njoftime për realizimin e seancave për konsultim publik, por vetëm në faqen Facebook të bashkisë është publikuar kalendari i konsultimeve publike për buxhetin 2024.	
7	Konsultimi publik i buxhetit vjetor të Bashkisë	Bashkia Fier e ka konsultuar me qytetarët buxhetin vjetor të Bashkisë.	
8	Konsultimi publik i paketës së taksave dhe tarifave vendore	Bashkia Fier e ka konsultuar me qytetarët paketën e taksave dhe tarifave vendore.	
9	Konsultimi publik i vendimeve për tjetërsimin e pronave të Bashkisë	Bashkia Fier nuk ka pasur vendimarrje për tjetërsim të pronave për periudhën Janar 2023 – Dhjetor 2023.	
10	Publikimi i Urdhërave dhe Vendimeve të Kryetarit të Bashkisë	Bashkia Fier nuk e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të urdhërave dhe vendimeve të kryetarit të bashkisë	
11	Njoftimi i datës dhe orës së mbledhjeve të Këshillit Bashkiak në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Fier ka vendosur në stendë dhe në faqen web, njoftime paraprake lidhur me njoftimet për mbledhjet e këshillit bashkiak.	
12	Njoftimi i datës dhe orës së mbledhjeve të komisioneve të Këshillit Bashkiak në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Fier nuk ka vendosur në stendat e njoftimeve dhe në faqen zyrtare të internetit, njoftime paraprake lidhur me njoftimet për mbledhjet e komisioneve të këshillit bashkiak, vetëm në faqen e facebook të Bashkisë.	
13	Publikimi i Proces-Verbaleve të mbledhjeve të Këshillit Bashkiak	Bashkia Fier nuk e ka realizuar detyrimin për publikimin e procesverbaleve të mbledhjeve të këshillit bashkiak.	
14	Publikimi i Vendimeve të Këshillit Bashkiak	Bashkia Fier e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të të vendimeve të këshillit bashkiak.,	




15	Vendosja e njoftimeve për organizimin e dëgjësive publike nga Këshilli Bashkiak në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Fier ka vendosur në stendat e njoftimeve dhe nuk publikuar në faqen zyrtare të internetit, njoftime lidhur me zhvillimin e dëgjësive publike nga këshilli bashkiak.	
16	A janë publikuar në faqen e internetit apo në stendën e njoftimeve publike raporte të zbatimit të buxhetit?	Bashkia Fier nuk ka publikuar raporte mbi zbatimin e buxhetit.	
17	Totali i Realizimit		68.7%

BASHKIA KAVAJË

Për Bashkinë Kavajë janë monitoruar të gjithë indikatorët sipas metodologjisë së përshkruar më sipër dhe gjetjet e kësaj Bashkie për secilin prej këtyre indikatorëve janë si më poshtë:

Nr	Indikatori	Komente	Statusi
1	Publikimi i Programit të Transparencës në faqen e internetit të Bashkisë	Bashkia Kavajë nuk e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të Programit të Transparencës.	
2	Caktimi dhe publikimi i të dhënave për Koordinatorin e Njoftimit dhe Konsultimit Publik	Bashkia Kavajë nuk e ka realizuar detyrimin për publikimin e të dhënave të koordinatorit të konsultimit publik, pasi në faqen zyrtare të internetit nuk ka shënuar adresën e emailit dhe numrin e telefonit e koordinatorit.	
3	Caktimi dhe publikimi i të dhënave për Koordinatorin për të Drejtën dhe Informimin	Bashkia Kavajë nuk e ka realizuar detyrimin për caktimin dhe publikimin e të dhënave të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit.	
4	Publikimi i Strukturës Organizative të Bashkisë	Bashkia Kavajë nuk e ka realizuar detyrimin për publikimin strukturës organizative të bashkisë.	
5	Publikimi i buxhetit vjetor të Bashkisë	Bashkia Kavajë nuk e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të buxhetit vjetor.	
6	Vendosja e njoftimeve për organizimin e seancave për konsultimin publik në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Kavajë nuk ka të publikuar në internet apo stendë njoftime për realizimin e seancave për konsultim publik.	
7	Konsultimi publik i buxhetit vjetor të Bashkisë	Bashkia Kavajë e ka konsultuar me qytetarët buxhetin vjetor 2024 të Bashkisë.	
8	Konsultimi publik i paketës së taksave dhe tarifave vendore	Bashkia Kavajë e ka konsultuar me qytetarët paketën e taksave dhe tarifave vendore.	
9	Konsultimi publik i vendimeve për tjetërsimin e pronave të Bashkisë	Bashkia Kavajë nuk ka pasur dëgjësia publike për tjetërsim prone pasi janë të ndaluara me ligjin Nr. 77/2022 „Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 133/2015 „Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave“.	



RAPORT MONITORIMI


TRANSPARENCA E 10 BASHKIVE DHE MATJA E 40 PREMTIMEVE TË KRYEBASHKIAKVE

10	Publikimi i Urdhërave dhe Vendimeve të Kryetarit të Bashkisë	Bashkia Kavajë nuk e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të urdhërave dhe vendimeve të kryetarit të bashkisë	
11	Njoftimi i datës dhe orës së mbledhjeve të Këshillit Bashkiak në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Kavajë nuk ka vendosur në stendë dhe në faqen e internetit, njoftime paraprake lidhur me njoftimet për mbledhjet e këshillit bashkiak. Kërkesës për informacion, Bashkia iu përgjigj duke theksuar se këto njoftime janë bërë në rrjete social, të cilat sidoqoftë nuk janë kanal zyrtar informacioni.	
12	Njoftimi i datës dhe orës së mbledhjeve të komisioneve të Këshillit Bashkiak në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Kavajë nuk ka vendosur në stendat e njoftimeve dhe në faqen zyrtare të internetit, njoftime paraprake lidhur me njoftimet për mbledhjet e komisioneve të këshillit bashkiak.	
13	Publikimi i Proces-Verbaleve të mbledhjeve të Këshillit Bashkiak	Bashkia Kavajë nuk e ka realizuar detyrimin për publikimin e procesverbaleve të mbledhjeve të këshillit bashkiak.	
14	Publikimi i Vendimeve të Këshillit Bashkiak	Bashkia Kavajë nuk e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të vendimeve të këshillit bashkiak.	
15	Vendosja e njoftimeve për organizimin e dëgjësive publike nga Këshilli Bashkiak në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Kavajë nuk ka vendosur në stendat e njoftimeve dhe publikuar në faqen zyrtare të internetit, njoftime lidhur me zhvillimin e dëgjësive publike nga këshilli bashkiak por vetëm në faqen zyrtare facebook të bashkisë.	
16	A janë publikuar në faqen e internetit apo në stendën e njoftimeve publike raporte të zbatimit të buxhetit?	Bashkia Kavajë nuk ka publikuar të dhëna mbi zbatimin e buxhetit.	
17	Totali i Realizimit		18.7%


BASHKIA DURRËS

Për Bashkinë Durrës janë monitoruar të gjithë indikatorët sipas metodologjisë së përshkruar më sipër dhe gjetjet e kësaj Bashkie për secilin prej këtyre indikatorëve janë si më poshtë.

Nr	Indikatori	Komente	Statusi
1	Publikimi i Programit të Transparencës në faqen e internetit të Bashkisë	Bashkia Durrës e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të Programit të Transparencës.	
2	Caktimi dhe publikimi i të dhënave për Koordinatorin e Njoftimit dhe Konsultimit Publik	Bashkia Durrës nuk e ka realizuar detyrimin për publikimin e të dhënave të koordinatorit të konsultimit publik.	
3	Caktimi dhe publikimi i të dhënave për Koordinatorin për të Drejtën dhe Informimin	Bashkia Durrës e ka realizuar detyrimin për caktimin dhe publikimin e të dhënave të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit.	
4	Publikimi i Strukturës Organizative të Bashkisë	Bashkia Durrës e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të strukturës organizative të bashkisë.	



5	Publikimi i buxhetit vjetor të Bashkisë	Bashkia Durrës e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të buxhetit vjetor përgjatë viteve.	
6	Vendosja e njoftimeve për organizimin e seancave për konsultimin publik në faqen e internetit apo standën e njoftimeve publike	Bashkia Durrës ka të publikuar në internet njoftime për realizimin e seancave për konsultim publik.	
7	Konsultimi publik i buxhetit vjetor të Bashkisë	Bashkia Durrës e ka konsultuar me qytetarët buxhetin vjetor të Bashkisë. Nga vëzhgimi i faqes së internetit dhe nga standat e njoftimit, janë publikuar njoftime për zhvillimin e proceseve konsultuese për buxhetin vjetor të Bashkisë.	
8	Konsultimi publik i paketës së taksave dhe tarifave vendore	Bashkia Durrës e ka konsultuar me qytetarët paketën e taksave dhe tarifave vendore. Nga vëzhgimi i faqes së internetit dhe i standave të njoftimeve janë konstatuar realizime aktiviteteve për përmbushjen e këtij detyrimi.	
9	Konsultimi publik i vendimeve për tjetërsimin e pronave të Bashkisë	Kërkesës për informacion mbi këtë çështje, bashkia iu përgjigj që për periudhën Janar 2023- Dhjetor 2023 nuk ka pasur asnjë praktikë për tjetërsimin e pronave të Bashkisë Durrës.	
10	Publikimi i Urdhërave dhe Vendimeve të Kryetarit të Bashkisë	Bashkia Durrës nuk e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të urdhërave dhe vendimeve të kryetarit të bashkisë.	
11	Njoftimi i datës dhe orës së mbledhjeve të Këshillit Bashkiak në faqen e internetit apo standën e njoftimeve publike	Bashkia Durrës ka vendosur në standën e njoftimeve, njoftime paraprake lidhur me njoftimet për mbledhjet e këshillit bashkiak.	
12	Njoftimi i datës dhe orës së mbledhjeve të komisioneve të Këshillit Bashkiak në faqen e internetit apo standën e njoftimeve publike	Bashkia Durrës ka vendosur në standat e njoftimeve dhe ka publikuar në faqen zyrtare të internetit, njoftime paraprake lidhur me njoftimet për mbledhjet e komisioneve të këshillit bashkiak.	
13	Publikimi i Proces-Verbaleve të mbledhjeve të Këshillit Bashkiak	Bashkia Durrës nuk e ka realizuar detyrimin për publikimin e procesverbaleve të mbledhjeve të këshillit bashkiak.	
14	Publikimi i Vendimeve të Këshillit Bashkiak	Bashkia Durrës e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të të vendimeve të këshillit bashkiak.	
15	Vendosja e njoftimeve për organizimin e dëgjësive publike nga Këshilli Bashkiak në faqen e internetit apo standën e njoftimeve publike	Bashkia Durrës ka vendosur në standat e njoftimeve dhe publikuar në faqen zyrtare të internetit, njoftime lidhur me zhvillimin e dëgjësive publike nga këshilli bashkiak.	
16	A janë publikuar në faqen e internetit apo në standën e njoftimeve publike raporte të zbatimit të buxhetit?	Bashkia Durrës ka publikuar raporte të monitorimit të zbatimit të buxhetit.	
17	Totali i Realizimit		81.2%




RAPORT MONITORIMI

TRANSPARENCA E 10 BASHKIVE DHE MATJA E 40 PREMTIMEVE TË KRYEBASHKIAKVE

BASHKIA KORÇË

Për Bashkinë Korçë janë monitoruar të gjithë indikatorët sipas metodologjisë së përshkruar më sipër dhe gjetjet e kësaj Bashkie për secilin prej këtyre indikatorëve janë si më poshtë.

Nr	Indikatori	Komente	Statusi
1	Publikimi i Programit të Transparencës në faqen e internetit të Bashkisë	Bashkia Korçë e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të Programit të Transparencës.	
2	Caktimi dhe publikimi i të dhënave për Koordinatorin e Njoftimit dhe Konsultimit Publik	Bashkia Korçë e ka realizuar detyrimin për publikimin e të dhënave të koordinorit të konsultimit publik.	
3	Caktimi dhe publikimi i të dhënave për Koordinatorin për të Drejtën dhe Informimin	Bashkia Korçë e ka realizuar detyrimin për caktimin dhe publikimin e të dhënave të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit.	
4	Publikimi i Strukturës Organizative të Bashkisë	Bashkia Korçë e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të strukturës organizative të bashkisë.	
5	Publikimi i buxhetit vjetor të Bashkisë	Bashkia Korçë e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të buxhetit vjetor përgjatë viteve.	
6	Vendosja e njoftimeve për organizimin e seancave për konsultimin publik në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Korçë ka të publikuar në internet njoftime për realizimin e seancave për konsultim publik.	
7	Konsultimi publik i buxhetit vjetor të Bashkisë	Bashkia Korçë e ka konsultuar me qytetarët buxhetin vjetor të Bashkisë. Nga vëzhgimi i faqes së internetit dhe nga stendat e njoftimit, janë publikuar njoftime për zhvillimin e proceseve konsultuese për buxhetin vjetor të Bashkisë.	
8	Konsultimi publik i paketës së taksave dhe tarifave vendore	Bashkia Korçë e ka konsultuar me qytetarët paketën e taksave dhe tarifave vendore. Nga vëzhgimi i faqes së internetit dhe i stendave të njoftimeve janë konstatuar realizime aktiviteteve për përmbushjen e këtij detyrimi.	
9	Konsultimi publik i vendimeve për tjetërsimin e pronave të Bashkisë	Bashkia Korçë në përgjigjen e saj ka cilësuar se aktet e kalimit të pronësisë të miratura nga Këshilli Bashkiak janë akte administrative individuale për të cilat, detyrimi për konsultim publik i takon Këshillit Bashkiak.	
10	Publikimi i Urdhërave dhe Vendimeve të Kryetarit të Bashkisë	Bashkia Korçë e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të urdhërave dhe vendimeve të kryetarit të bashkisë.	
11	Njoftimi i datës dhe orës së mbledhjeve të Këshillit Bashkiak në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Korçë ka vendosur në stendën e njoftimeve, njoftime paraprake lidhur me njoftimet për mbledhjet e këshillit bashkiak.	
12	Njoftimi i datës dhe orës së mbledhjeve të komisioneve të Këshillit Bashkiak në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Korçë ka vendosur në stendat e njoftimeve dhe ka publikuar në faqen zyrtare të internetit, njoftime paraprake lidhur me njoftimet për mbledhjet e komisioneve të këshillit bashkiak.	
13	Publikimi i Proces-Verbaleve të mbledhjeve të Këshillit Bashkiak	Bashkia Korçë e ka realizuar detyrimin për publikimin e procesverbaleve të mbledhjeve të këshillit bashkiak.	




14	Publikimi i Vendimeve te Keshillit Bashkiak	Bashkia Korçë e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të vendimeve të këshillit bashkiak.	
15	Vendosja e njoftimeve për organizimin e dëgjësave publike nga Këshilli Bashkiak në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Korçë ka vendosur në stendat e njoftimeve dhe publikuar në faqen zyrtare të internetit, njoftime lidhur me zhvillimin e dëgjësave publike nga këshilli bashkiak.	
16	A janë publikuar në faqen e internetit apo në stendën e njoftimeve publike raporte të zbatimit të buxhetit?	Bashkia Korçë ka publikuar raporte te monitorimit të zbatimit të buxhetit.	
17	Totali i Realizimit		100%

BASHKIA LEZHË

Për Bashkinë Lezhë janë monitoruar të gjithë indikatorët sipas metodologjisë së përshkruar më sipër dhe gjetjet e kësaj Bashkie për secilin prej këtyre indikatorëve janë si më poshtë:

Nr	Indikatori	Komente	Statusi
1	Publikimi i Programit të Transparencës në faqen e internetit të Bashkisë	Bashkia Lezhë e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të Programit të Transparencës.	
2	Caktimi dhe publikimi i të dhënave për Koordinatorin e Njoftimit dhe Konsultimit Publik	Bashkia Lezhë e ka realizuar detyrimin për publikimin e të dhënave të koordinorit të konsultimit publik.	
3	Caktimi dhe publikimi i të dhënave për Koordinatorin për të Drejtën dhe Informimin	Bashkia Lezhë e ka realizuar detyrimin për caktimin dhe publikimin e të dhënave të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit.	
4	Publikimi i Strukturës Organizative të Bashkisë	Bashkia Lezhë e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të strukturës organizative të bashkisë.	
5	Publikimi i buxhetit vjetor të Bashkisë	Bashkia Lezhë e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të buxhetit vjetor përgjatë viteve.	
6	Vendosja e njoftimeve për organizimin e seancave për konsultimin publik në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Lezhë ka të publikuar në internet njoftime për realizimin e seancave për konsultim publik.	
7	Konsultimi publik i buxhetit vjetor të Bashkisë	Bashkia Lezhë e ka konsultuar me qytetarët buxhetin vjetor të Bashkisë. Nga vëzhgimi i faqes së internetit dhe nga stendat e njoftimit, janë publikuar njoftime për zhvillimin e proceseve konsultuese për buxhetin vjetor të Bashkisë.	
8	Konsultimi publik i paketës së taksave dhe tarifave vendore	Bashkia Lezhë e ka konsultuar me qytetarët paketën e taksave dhe tarifave vendore. Nga vëzhgimi i faqes së internetit dhe i stendave të njoftimeve janë konstatuar realizime aktiviteteve për përmbushjen e këtij detyrimi.	



RAPORT MONITORIMI


TRANSPARENCA E 10 BASHKIVE DHE MATJA E 40 PREMTIMEVE TË KRYEBASHKIAKVE

9	Konsultimi publik i vendimeve për tjetërsimin e pronave të Bashkisë	Bashkia Lezhë e ka plotësuar këtë kërkesë ligjore.	
10	Publikimi i Urdhërave dhe Vendimeve të Kryetarit të Bashkisë	Bashkia Lezhë e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të urdhërave dhe vendimeve të kryetarit të bashkisë.	
11	Njoftimi i datës dhe orës së mbledhjeve të Këshillit Bashkiak në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Lezhë ka vendosur në stendën e njoftimeve, njoftime paraprake lidhur me njoftimet për mbledhjet e këshillit bashkiak.	
12	Njoftimi i datës dhe orës së mbledhjeve të komisioneve të Këshillit Bashkiak në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Lezhë ka vendosur në stendat e njoftimeve dhe ka publikuar në faqen zyrtare të internetit, njoftime paraprake lidhur me njoftimet për mbledhjet e komisioneve të këshillit bashkiak.	
13	Publikimi i Proces-Verbaleve të mbledhjeve të Këshillit Bashkiak	Bashkia Lezhë e ka realizuar detyrimin për publikimin e procesverbaleve të mbledhjeve të këshillit bashkiak.	
14	Publikimi i Vendimeve të Këshillit Bashkiak	Bashkia Lezhë e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të të vendimeve të këshillit bashkiak.	
15	Vendosja e njoftimeve për organizimin e dëgjësave publike nga Këshilli Bashkiak në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Lezhë ka vendosur në stendat e njoftimeve dhe publikuar në faqen zyrtare të internetit, njoftime lidhur me zhvillimin e dëgjësave publike nga këshilli bashkiak.	
16	A janë publikuar në faqen e internetit apo në stendën e njoftimeve publike raporte të zbatimit të buxhetit?	Bashkia Lezhë ka publikuar raporte të monitorimit të zbatimit të buxhetit.	
17	Totali i Realizimit		100%


BASHKIA SHKODËR

Për Bashkinë Shkodër janë monitoruar të gjithë indikatorët sipas metodologjisë së përshkruar më sipër dhe gjetjet e kësaj Bashkie për secilin prej këtyre indikatorëve janë si më poshtë.

Nr	Indikatori	Komente	Statusi
1	Publikimi i Programit të Transparencës në faqen e internetit të Bashkisë	Bashkia Shkodër e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të Programit të Transparencës.	
2	Caktimi dhe publikimi i të dhënave për Koordinatorin e Njoftimit dhe Konsultimit Publik	Bashkia Shkodër e ka realizuar detyrimin për publikimin e të dhënave të koordinatorit të konsultimit publik, pasi në faqen zyrtare të internetit ka shënuar adresën e emailit dhe të dhënat e koordinatorit.	
3	Caktimi dhe publikimi i të dhënave për Koordinatorin për të Drejtën dhe Informimin	Bashkia Shkodër e ka realizuar detyrimin për caktimin dhe publikimin e të dhënave të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit.	



4	Publikimi i Strukturës Organizative të Bashkisë	Bashkia Shkodër e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen e strukturës organizative të bashkisë.	
5	Publikimi i buxhetit vjetor të Bashkisë	Bashkia Shkodër e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të buxhetit vjetor përgjatë viteve.	
6	Vendosja e njoftimeve për organizimin e seancave për konsultimin publik në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Shkodër ka të publikuar në internet apo stendë njoftime për realizimin e seancave për konsultim publik.	
7	Konsultimi publik i buxhetit vjetor të Bashkisë	Bashkia Shkodër e ka konsultuar me qytetarët buxhetin vjetor të Bashkisë.	
8	Konsultimi publik i paketës së taksave dhe tarifave vendore	Bashkia Shkodër e ka konsultuar me qytetarët paketën e taksave dhe tarifave vendore.	
9	Konsultimi publik i vendimeve për tjetërsimin e pronave të Bashkisë	Bashkia Shkodër e ka plotësuar këtë kërkesë ligjore.	
10	Publikimi i Urdhërave dhe Vendimeve të Kryetarit të Bashkisë	Bashkia Shkodër e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të urdhërave dhe vendimeve të kryetarit të bashkisë	
11	Njoftimi i datës dhe orës së mbledhjeve të Këshillit Bashkiak në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Shkodër ka vendosur në stendë, njoftime paraprake lidhur me njoftimet për mbledhjet e këshillit bashkiak.	
12	Njoftimi i datës dhe orës së mbledhjeve të komisioneve të Këshillit Bashkiak në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Shkodër ka vendosur në stendat e njoftimeve dhe në faqen zyrtare të internetit, njoftime paraprake lidhur me njoftimet për mbledhjet e komisioneve të këshillit bashkiak.	
13	Publikimi i Proces-Verbaleve të mbledhjeve të Këshillit Bashkiak	Bashkia Shkodër e ka realizuar detyrimin për publikimin e procesverbaleve të mbledhjeve të këshillit bashkiak.	
14	Publikimi i Vendimeve të Këshillit Bashkiak	Bashkia Shkodër e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të vendimeve të këshillit bashkiak.	
15	Vendosja e njoftimeve për organizimin e dëgjësive publike nga Këshilli Bashkiak në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Shkodër ka vendosur në stendat e njoftimeve dhe publikuar në faqen zyrtare të internetit, njoftime lidhur me zhvillimin e dëgjësive publike nga këshilli bashkiak.	
16	A janë publikuar në faqen e internetit apo në stendën e njoftimeve publike raporte të zbatimit të buxhetit?	Bashkia Shkodër ka publikuar raporte mbi zbatimin e buxhetit.	
17	Totali i Realizimit		100%




RAPORT MONITORIMI

TRANSPARENCA E 10 BASHKIVE DHE MATJA E 40 PREMTIMEVE TË KRYEBASHKIAKVE

BASHKIA VLORË

Për Bashkinë Vlorë janë monitoruar të gjithë indikatorët sipas metodologjisë së përshkruar më sipër dhe gjetjet e kësaj Bashkie për secilin prej këtyre indikatorëve janë si më poshtë.

Nr	Indikatori	Komente	Statusi
1	Publikimi i Programit të Transparencës në faqen e internetit të Bashkisë	Bashkia Vlorë e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të Programit të Transparencës.	✓
2	Caktimi dhe publikimi i të dhënave për Koordinatorin e Njoftimit dhe Konsultimit Publik	Bashkia Vlorë e ka realizuar detyrimin për publikimin e të dhënave të koordinitorit të konsultimit publik, pasi në faqen zyrtare të internetit ka shënuar adresën e emailit dhe të dhënat e koordinitorit.	✓
3	Caktimi dhe publikimi i të dhënave për Koordinatorin për të Drejtën dhe Informimin	Bashkia Vlorë e ka realizuar detyrimin për caktimin dhe publikimin e të dhënave të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit.	✓
4	Publikimi i Strukturës Organizative të Bashkisë	Bashkia Vlorë e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen e strukturës organizative të bashkisë.	✓
5	Publikimi i buxhetit vjetor të Bashkisë	Bashkia Vlorë e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të buxhetit vjetor përgjatë viteve.	✓
6	Vendosja e njoftimeve për organizimin e seancave për konsultimin publik në faqen e internetit apo standën e njoftimeve publike	Bashkia Vlorë ka të publikuar në internet apo standë njoftime për realizimin e seancave për konsultim publik.	✓
7	Konsultimi publik i buxhetit vjetor të Bashkisë	Bashkia Vlorë e ka konsultuar me qytetarët buxhetin vjetor të Bashkisë.	✓
8	Konsultimi publik i paketës së taksave dhe tarifave vendore	Bashkia Vlorë e ka konsultuar me qytetarët paketën e taksave dhe tarifave vendore.	✓
9	Konsultimi publik i vendimeve për tjetërsimin e pronave të Bashkisë	Bashkia Vlorë në përgjigjen e saj cilëson se Këshilli Bashkiak nuk ka organizuar konsultime me publikun me qëllimin e diskutimit të tjetërsimit të pronave publike.	✗
10	Publikimi i Urdhërave dhe Vendimeve të Kryetarit të Bashkisë	Bashkia Vlorë nuk e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të urdhërave dhe vendimeve të kryetarit të bashkisë	✗
11	Njoftimi i datës dhe orës së mbledhjeve të Këshillit Bashkiak në faqen e internetit apo standën e njoftimeve publike	Bashkia Vlorë ka vendosur në standë, njoftime paraprake lidhur me njoftimet për mbledhjet e këshillit bashkiak.	✓
12	Njoftimi i datës dhe orës së mbledhjeve të komisioneve të Këshillit Bashkiak në faqen e internetit apo standën e njoftimeve publike	Bashkia Vlorë nuk ka vendosur në standat e njoftimeve dhe në faqen zyrtare të internetit, njoftime paraprake lidhur me njoftimet për mbledhjet e komisioneve të këshillit bashkiak.	✗
13	Publikimi i Proces-Verbaleve të mbledhjeve të Këshillit Bashkiak	Bashkia Vlorë e ka realizuar detyrimin për publikimin e procesverbaleve të mbledhjeve të këshillit bashkiak.	✓
14	Publikimi i Vendimeve të Këshillit Bashkiak	Bashkia Vlorë e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të të vendimeve të këshillit bashkiak.	✓




15	Vendosja e njoftimeve për organizimin e dëgjesave publike nga Këshilli Bashkiak në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Vlorë ka vendosur në stendat e njoftimeve dhe nuk publikuar në faqen zyrtare të internetit, njoftime lidhur me zhvillimin e dëgjesave publike nga këshilli bashkiak.	
16	A janë publikuar në faqen e internetit apo në stendën e njoftimeve publike raporte të zbatimit të buxhetit?	Bashkia Vlorë nuk ka publikuar raporte mbi zbatimin e buxhetit.	
17	Totali i Realizimit		75%

BASHKIA HIMARË

Për Bashkinë Himarë janë monitoruar të gjithë indikatorët sipas metodologjisë së përshkruar më sipër dhe gjetjet e kësaj Bashkie për secilin prej këtyre indikatorëve janë si më poshtë.

Nr	Indikatori	Komente	Statusi
1	Publikimi i Programit të Transparencës në faqen e internetit të Bashkisë	Bashkia Himarë e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të Programit të Transparencës.	
2	Caktimi dhe publikimi i të dhënave për Koordinatorin e Njoftimit dhe Konsultimit Publik	Bashkia Himarë e ka realizuar detyrimin për publikimin e të dhënave të koordinorit të konsultimit publik, pasi në faqen zyrtare të internetit ka shënuar adresën e emailit dhe të dhënat e koordinorit.	
3	Caktimi dhe publikimi i të dhënave për Koordinatorin për të Drejtën dhe Informimin	Bashkia Himarë e ka realizuar detyrimin për caktimin dhe publikimin e të dhënave të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit.	
4	Publikimi i Strukturës Organizative të Bashkisë	Bashkia Himarë e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen e strukturës organizative të bashkisë.	
5	Publikimi i buxhetit vjetor të Bashkisë	Bashkia Himarë nuk e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të buxhetit vjetor përgjatë viteve.	
6	Vendosja e njoftimeve për organizimin e seancave për konsultimin publik në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Himarë ka të publikuar në internet apo stendë njoftime për realizimin e seancave për konsultim publik.	
7	Konsultimi publik i buxhetit vjetor të Bashkisë	Bashkia Himarë e ka konsultuar me qytetarët buxhetin vjetor të Bashkisë.	
8	Konsultimi publik i paketës së taksave dhe tarifave vendore	Bashkia Himarë e ka konsultuar me qytetarët paketën e taksave dhe tarifave vendore.	
9	Konsultimi publik i vendimeve për tjetërsimin e pronave të Bashkisë	Nga vëzhgimi i faqes së internetit dhe i stendave të njoftimeve nuk janë konstatuar realizime aktivitesh për përmbushjen e këtij detyrimi. Faktikisht, Bashkia mund të mos ketë realizuar tjetërsime pronash. Kërkesës për informacion mbi këtë çështje, bashkia nuk iu përgjigj, prandaj po e cilësojmë si indikator të porealizuar.	



RAPORT MONITORIMI

TRANSPARENCA E 10 BASHKIVE DHE MATJA E 40 PREMTIMEVE TË KRYEBASHKIAKVE

10	Publikimi i Urdhërave dhe Vendimeve të Kryetarit të Bashkisë	Bashkia Himarë nuk e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të urdhërave dhe vendimeve të kryetarit të bashkisë	
11	Njoftimi i datës dhe orës së mbledhjeve të Këshillit Bashkiak në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Himarë nuk ka vendosur në stendë dhe në faqen e internetit, njoftime paraprake lidhur me njoftimet për mbledhjet e këshillit bashkiak.	
12	Njoftimi i datës dhe orës së mbledhjeve të komisioneve të Këshillit Bashkiak në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Himarë nuk ka vendosur në stendat e njoftimeve dhe në faqen zyrtare të internetit, njoftime paraprake lidhur me njoftimet për mbledhjet e komisioneve të këshillit bashkiak.	
13	Publikimi i Proces-Verbaleve të mbledhjeve të Këshillit Bashkiak	Bashkia Himarë nuk e ka realizuar detyrimin për publikimin e procesverbaleve të mbledhjeve të këshillit bashkiak.	
14	Publikimi i Vendimeve të Këshillit Bashkiak	Bashkia Himarë nuk e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të vendimeve të këshillit bashkiak.	
15	Vendosja e njoftimeve për organizimin e dëgjësave publike nga Këshilli Bashkiak në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Himarë nuk ka vendosur në stendat e njoftimeve dhe nuk publikuar në faqen zyrtare të internetit, njoftime lidhur me zhvillimin e dëgjësave publike nga këshilli bashkiak.	
16	A janë publikuar në faqen e internetit apo në stendën e njoftimeve publike raporte të zbatimit të buxhetit?	Bashkia Himarë nuk ka publikuar raporte të zbatimit të buxhetit.	
17	Totali i Realizimit		43.7%

ANALIZË KRAHASUESE

Në tabelën më poshtë janë përmbledhur rezultatet e monitorimit për të dhjetë bashkitë e monitoruara, të renditura sipas rezultatit në indeksin e transparencës. Vlen të theksohet se për katër bashkitë Shkodër, Lezhë, Dibër dhe Durrës të cilat u monitoruan dhe vitin e kaluar, Bashkia Shkodër dhe Bashkia Lezhë ruajnë të njëjtin nivel transparence, ndërsa Bashkitë Dibër dhe Durrës kanë rritje të nivelit të tyre të transparencës.

Bashkitë me performancën më të lartë janë ato të Shkodrës, Korçës dhe Lezhës me 100%, ndjekur nga Bashkia e Dibrës e cila e ka realizuar kërkesat e legjislacionit sa i përket transparencës në masën 87.5% duke realizuar 14 nga 16 indikatorët e matur. Ndërkohë, Bashkia me performancën më të dobët është Bashkia e Kavajës niveli i transparencës së të cilës është vetëm 18.7%.

Sa u përket indikatorëve, vërehet se pothuajse të gjitha bashkitë e monitoruara e kanë publikuar Programin e Transparencës në faqen e tyre të internetit, përveç Bashkisë Kavajë. Ndërkohë, 9 nga 10 bashkitë e monitoruara kanë caktuar dhe publikuar të dhënat për Koordinatorin për të Drejtën e Informimit, ndërsa

8 nga 10 bashkitë e monitoruara, kanë caktuar Koordinatorin për Konsultimin Publik.

Bashkitë kanë një performancë të mirë në konsultimin publik të Buxhetit Vjetor dhe në publikimin e tij në faqen e internetit. Në këtë mënyrë, 9 nga 10 bashkitë e monitoruara kanë realizuar konsultime publike për hartimin e buxhetit por 8 nga 10 e kanë publikuar buxhetin vjetor. Performanca është e njëjtë sa i përket konsultimeve me publike për paketën e taksave dhe tarifave vendore ku 9 nga 10 bashkitë e monitoruara kanë zhvilluar konsultime publike për këtë çështje.

Sa i përket transparencës së Këshillit Bashkiak, 8 nga 10 bashkitë e monitoruara kanë njoftuar datën dhe orën e Mbledhjes së Këshillit, Bashkiak. Vetëm 5 nga 10 bashkitë e monitoruara kanë publikuar Proces-Verbalet e Mbledhjeve të Këshillit Bashkiak. Nga ana tjetër, 8 nga 10 bashkitë e monitoruara kanë publikuar Vendimet e Këshillit Bashkiak.

Transparenca është shumë e ulët sa i përket publikimit të Vendimeve dhe Urdhërave të Kryetarit të Bashkisë. Vetëm 3 nga 10 bashkitë e monitoruara i kanë publikuar urdhërat apo vendimet e Kryetarit.

Nr	Bashkia	Indeksi i Transparencës
1	Bashkia Shkodër	100%
2	Bashkia Korçë	100%
3	Bashkia Lezhë	100%
4	Bashkia Dibër	87.5%
5	Bashkia Durrës	81.2%
6	Bashkia Vlorë	75%
7	Bashkia Fier	68.7%
8	Bashkia Elbasan	62.5%
9	Bashkia Himarë	43.7%
10	Bashkia Kavajë	18.7%

MONITORIMI I PREMTIMEVE

Ekipi i Faktoje përzgjodhi katër premtime të bëra gjatë fushatës elektorale në zgjedhjet vendore Maj 2023, si dhe premtime që lidhen me procesin e rindëtimimit për bashki të prekura nga tërmeti i viti 2019. Për monitorimin e këtyre premtimeve është ndjekur metodologjia e mëposhtme:

METODOLOGJIA

Premtimet për shërbimet publike mund të ndahen në dy grupe të mëdha:

- 1 Premtimet që lidhen me aktet administrative mbi uljen apo heqjen e taksave e tarifave apo për kthimin e një hapësire publike në pedonale, apo për hapjen e një qendre sociale, kinemaje, etj.

Mbajtja e këtyre premtimeve realizohet përmes miratimit të akteve administrative ligjore si Vendimet dhe Urdhërat e Kryetarit të Bashkisë dhe Vendimet e Këshillit Bashkiak. Disa prej këtyre premtimeve kanë edhe efekte financiare dhe për këtë duhet analizuar edhe buxheti për të parë nëse janë parashikuar fonde për ngritjen e një strukture të re;


- 2 Premtimet që lidhen kryesisht me infrastrukturën publike që përbëjnë detyrat dhe kompetencat kryesore të bashkive si ujësjellësi dhe kanalizimet, rrugët dhe hapësirat e gjelbërta, shkollat dhe kopshtet, qendrat shëndetësore, qendrat sociale dhe godinat e tjera publike, etj. Mbajtja e këtyre premtimeve lidhet ngushtësisht me buxhetin e bashkive.

Për të analizuar dhe dokumentuar mbajtjen e këtyre premtimeve fillimisht duhet parë nëse ato janë përfshirë buxhetin e Bashkisë, më saktësisht në "Shpenzimet Kapitale" apo në "Shpenzimet e Mirëmbajtjes". Megjithatë, edhe nëse janë përfshirë në buxhet, nuk do të thotë se premtimet do të mbahen pasi bashkitë pothuajse gjithmonë nuk i përmbahen angazhimeve të buxhetit. Prandaj është me rëndësi që të shihet edhe nëse një bashki ka bërë ose planifikon të bëjë prokurimin publik për projektin në fjalë. Plani i prokurimeve mund të shihet në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik.

Vlen të theksohet se realizimi i disa prej këtyre premtimeve mund të bëhen edhe në bashkëpunim apo me ndihmën e institucioneve të tjera, si Ministrinë e Linjës, psh, Ministria e Shëndetësisë për qendrat shëndetësore apo AKUM për ujësjellësat apo landfillet. Prandaj është e rëndësishme që të studiohen edhe buxhetet dhe prokurimet e këtyre institucioneve për të parë nëse e kanë përfshirë këtë projekt apo jo. Si rredhim, në bazën e të dhënave parashikohet të ekzistojë edhe seksioni "Institucion tjetër i përfshirë" për të identifikuar dhe monitoruar edhe këto institucione që mund të financojnë plotësisht apo bashkë-financojnë me bashkitë implementimin e këtyre projekteve.

Indikatorët që propozohet të maten, sa u takon Shërbimeve Publike, janë:

- 1 Vendimet dhe Urdhërat e Kryetarit të Bashkisë;
- 2 Vendimet e Këshillit Bashkiak;
- 3 Buxheti;



- 4 Plani i Prokurimeve;
- 5 Lista e Kontratave të Shpallura;
- 6 Buxheti i Institucioneve të tjera të Përfshira dhe plani i tyre i prokurimeve.

PROJEKTET E MËDHA

Projektet e mëdha përfshijnë projekte që kërkojnë një financim shumë të madh krahasuar me buxhetin e një bashkie e kërkojnë domosdoshmërisht përfshirjen dhe financimet e Qeverisë Qëndrore. Në këto projekte përfshihen Autostradat dhe Rrugët Kombëtare, Portet, Aeroportet dhe Terminale, Spitalet, Teatrot, Stadiumet, etj.

Këto projekte, pavarësisht se mund të jenë premtuar nga Kryebashkiakët, faktikisht janë jashtë kopetencave të Bashkisë. Por, premtimi i kryetarëve mund të lidhet edhe me lobimin pranë Qeverisë apo Ministrive për financimin e këtyre projekteve. Prandaj, për monitorimin e realizimit të këtyre premtimeve duhet të monitorohet buxheti dhe plani i prokurimeve i institucionit qendror e jo i bashkisë.

Indikatorët që propozohet të maten, sa u takon Projekteve të Mëdha, janë:

- ◆ Buxheti i Institucioneve qendrore në varësi të fushës, si psh. Ministrisë së Shëndetësisë për Spitalet, FSHF/MASR për Stadiumet, FSHZH apo ARRSH për rrugët, etj.

Për monitorimin e realizimit të këtyre premtimeve, Ekipi i Faktoje ndërmorri hapat e mëposhtme:

- 1 Analiza e buxhetit të bashkive;
- 2 Analiza e Planit të Prokurimeve;
- 3 Dërgimi i kërkesave për informacion pranë bashkive;
- 4 Realizimi i vizitave në terren për të parë gjendjen nga afër.

PREMTIMET E MONITORUARA

Premtimet e përzgjedhura për secilën nga Bashkitë e përfshira në projekt janë si më poshtë.

BASHKIA ELBASAN

- ◆ Rindërtimi i shkollës "Jonuz Carciu" dhe rindërtimi i shkollës 9-vjeçare "Naim Frashëri"
- ◆ Ndërtimi i pikës së grumbullimit të frutave në Shushicë, Bradashesh;
- ◆ Ndërtimi i rrugës së Funarit;
- ◆ Pastrimi i përroit të Shushicës.

BASHKIA LEZHË

- ◆ Rindërtimi i Pallatit të Kulturës "Dedë Ndue Lazri", Lezhë
- ◆ Ndërtimi i Rrugës së Tales
- ◆ Projekti "Dua të luaj"
- ◆ Rindërtimi i pallatit në lagjen " Besëlidhja"

BASHKIA SHKODËR


- ◆ Rikualifikimi i tregut në lagjen Rus në Shkodër
- ◆ Rehabilitimi i rrugëve Bërdic-Bahcallëk dhe rruga Shirokë-Zogaj
- ◆ Ndërtimi i molit të ri në Shkodër
- ◆ Aksioni për lirim të hapësirave publike

BASHKIA KORÇË

- ◆ Rehabilitimi i rrugëve Lekas-Voskopojë dhe Voskopojë-Krushovë
- ◆ Zgjidhja e situatës për ujrat e ndotura në Melçan
- ◆ Ndërtimi i një resorti dimëror - SKIPISTA
- ◆ Ndërtimi i një aeroporti turistik dhe sportiv në Korçë

BASHKIA DIBËR

- ◆ Premtime për asfaltim rrugësh (Lagjja Lekaçe)
- ◆ Asfaltimi i rrugës së Brestit të sipërm
- ◆ Vadtja e 500 ha toka bijqësore në Maqellarë
- ◆ Fasadat e qytetit



RAPORT MONITORIMI

TRANSPARENCA E 10 BASHKIVE DHE MATJA E 40 PREMTIMEVE TË KRYEBASHKIAKVE

BASHKIA DURRËS

- ◆ Ndërtimi i godinës së parkingut publik në qendër të qytetit
- ◆ Shtrimi i dy rrugëve në Sukth
- ◆ Rikonstruksioni i Qendrës Kulturore për Fëmijë/ QKF-së
- ◆ Rehabilitimi i pallateve të viteve 90' si modeli i lagjjes 18.

BASHKIA KAVAJË

- ◆ Bonuse mujore në vlerën 5,000 ALL për çdo lindje të re.
- ◆ Pastrimi i menjëhershëm në qytet
- ◆ Ndërtimi i Parkut Rekreativ të të Kvajës
- ◆ Zgjidhja përfundimtare e çështjes së ujit (Fshati Karpen dhe Rrakull)

BASHKIA FIER

- ◆ Ndërtimi i një tregu bashkëkohor për tregëtimin me shumicë të produkteve bujqësore.

- ◆ Përfundimi i rehabilitimit të qendrës së Libofshës
- ◆ Ndërtimi i rrugës nga Manastiri i Ardenicës deri në kishën e shëngjergjit në Libofshë.
- ◆ Përfundimi për rehabilitimin e infrastrukturës rrugore në njësinë Levan & përfundimi i punës për rehabilitimin e sistemit kullues;

BASHKIA VLORË

- ◆ Pastrimi i qytetit
- ◆ Ndërtimi i terminalit të autobusëve ndërqytetas
- ◆ Ndërtimi i qendrave ditore për të moshuarit në çdo rajon të qytetit.
- ◆ Rikualifikimi i tregjeve të qytetit.

BASHKIA HIMARË

- ◆ Garantimi i ujit 24 orë për qytetin e Himarës
- ◆ Ndërtimi i rrugës në fshatin Tërbac
- ◆ Ndërtimi i rrugës në fshatin Kudhës
- ◆ Rikonstruksioni i rrugës së vjetër të Pilurit

ANALIZË PËRMBLEDHËSE MBI ÇËSHTJEN “BELERI”

Faktoje ka hasur një sërë vështirësish gjatë procesit të monitorimit të premtimeve dhe transparencës në bashkinë Himarë. Këto pengesa kanë ardhur kryesisht për shkak të ekzistencës së një situatë jo të zakonshme, si pasojë e çështjes së shumë përfolur të kryebashkiakut të zgjedhur Z. Dhionisios (Alfred) Beleri, i cili edhe në momentin e hartimit të këtij raporti vijon të vuajë masën e sigurimit personal shtrengues “Arrest në burg”, çka e ka penguar të kryejë betimin para Këshillit Bashkiak Himarë për marrjen zyrtarisht të detyrës.

Marrë parasysh kushtet në të cilat është kryer monitorimi, vlerësohet e domosdoshme që përtej monitorimit të premtimeve të bëhet edhe parashtrimi i një analize përmblendhëse lidhur me procesin penal/gjyqësor kundër Z. Beleri por edhe me procesin e mandatimit dhe betimit duke ju referuar vetëm fakteve dhe dokumenteve zyrtare të publikuara për këtë rast, marrë parasysh se ky rast është shoqëruar me shumë polemika e debate të forta politike, tensione e mosmarrëveshje dypalëshe me shtetin fqinj, Greqinë.

PËR KRONOLOGJI FAKTESH DHE RRETHANASH:

Në mbështetje të Dekretit nr. 13864, datë 24.10.2022, të Presidentit të Republikës, “Për caktimin e datës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore”, në datë 14 Maj 2023 janë zhvilluar zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore. Dy ditë para zgjedhjeve, në datë 12.05.2023, Z. Beleri u arrestua si autor i dyshuar për kryerjen e

veprës penale të “Korrupsionit aktiv në Zgjedhje” kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 328¹⁶ e 25 të Kodit Penal. Referuar procesverbalit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë¹⁷, arrestimi i Z. Beleri është kryer në flagrancë, ku ky shtetas në bashkëpunim me persona të tjerë, ka qenë duke premtuar dhe dhënë shuma monetare personave të ndryshëm me qëllim blerjen e votës.

Në deklaratën për shtyp¹⁸, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, u deklarua se hetimet kishin nisur që në datë 8 maj 2023 dhe Prokuroria e kishte regjistruar procedimin penal me nr. 489, datë 08.05.2023 mbi bazën e referimit të bërë nga Drejtoria Vendore e Policisë Vlorë, për veprën penale të “Korrupsionit aktiv në Zgjedhje”, në bashkëpunim, të parashikuar në nenet 328 dhe 25 të Kodit Penal (KP), në ngarkim të personave nën hetim Z. Beleri dhe P. K.


Me regjistrimin e procedimit penal, nga ana e prokurorit është autorizuar kryerja e një sërë veprimesh procedurale në terren, me anë të përdorimit të metodave speciale të hetimit, me qëllim konstatimin e faktit penal për të cilin është regjistruar ky procedim penal. Pas kryerjes së një sërë veprimesh nga strukturat e Drejtorisë Vendore të Policisë Vlorë, nën drejtimin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, bazuar në faktet e mbledhura gjatë hetimit dhe në provat e siguruara në dinamikë, me anë të përdorimit të metodave speciale të hetimit është bërë arrestimi në flagrancë i shtetasve Z. Beleri dhe P. K.¹⁹

¹⁶ Neni 328 Korrupsioni aktiv në zgjedhje (Ndryshuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012 dhe me ligjin nr. 89/2017, datë 22.5.2017, hequr fjalë me ligjin nr. 146/2020, datë 17.12.2020)Ofrimi ose dhënia e të hollave, të mirave materiale, premtimi për vend pune ose favorizime të tjera nëcilëndo formë, për zgjedhësin ose persona të tjerë të lidhur me të, me qëllim marrjen e firmës për paraqitjen e kandidatit në zgjedhje, për të votuar në një mënyrë të caktuar, për të marrë pjesë ose jo në votime, ose për t'u angazhuar në veprimtari të paligjshme për mbështetjen e një kandidati ose partie politike, përbën veprëpenale dhe dënohet me burgim nga një vit deri në pesë vjet.

¹⁷ <https://shqiptarja.com/lajm/nen-hetim-per-blerije-votash-del-dokumenti-urdher-arresti-i-firmosur-per-fredi-belerin>

¹⁸ <https://dosja.al/aktualitet/operacioni-matrix-ve-ne-pranga-fredi-belerin-prokurori-kemi-siguruar--i299736>

¹⁹ idem



RAPORT MONITORIMI

TRANSPARENCA E 10 BASHKIVE DHE MATJA E 40 PREMTIMEVE TË KRYEBASHKIAKVE

Arrestimi i të dyshuarve me vendimin nr. 205, datë 13.5.2023, është vleftësuar i ligjshëm nga Gjykata e Shkallës së Parë me Juridiksion të Përgjithshëm Vlorë, e cila ka caktuar ndaj secilit prej tyre masën e sigurimit personal "arrest në burg" parashikuar nga neni 238 i KPP. Gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar ndër të tjera se arrestimi në flagrancë është i ligjshëm, pasi secili prej personave nën hetim është arrestuar menjëherë pas kryerjes së veprës penale. Ajo gjithashtu ka vendosur deklarimin e moskompetencës të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, për gjykimin e çështjes penale dhe dërgimin e akteve në Gjykatën e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar Tiranë, si gjykatë kompetente nga pikëpamja lëndore.

Dosja e përcjellë për kompetencë është regjistruar në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar më datë 17.05.2023. Sipas procedurës së parashikuar në nenin 88 të KPP, gjykata e shkallës së parë e ka shqyrtuar çështjen me datë 22.5.2023.

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me vendimin nr. 46, datë 22.5.2023, ka vendosur:

1. *"Vazhdimin e zbatimit të masës së sigurimit personal "Arrest në burg"*
2. *Urdhërohet Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar si dhe Shërbimet e Policisë Gjyqësore për ekzekutimin e këtij vendimi. 3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, brenda 5 (pesë) ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit."*

Kundër këtij vendimi kanë paraqitur apel personat nën hetim Dhionisis Alfred Beleri dhe P.K, të cilët kanë kërkuar shfuqizimin e vendimit të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së parë; rrëzimin e kërkesës për caktim mase sigurimi personal, në alternativë një masë sigurimi më të butë.

Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me vendimin nr. 19, datë

1.6.2023, ka vendosur: *"Miratimin e Vendimit nr. 46, datë 22.05.2023, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin e Krimin e Organizuar"*.


Kundër vendimit nr. 19, datë 1.6.2023, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, kanë paraqitur rekurs personat nën hetim Dhionisis Alfred Beleri dhe P.K, të cilët kanë kërkuar: *"Shfuqizimin e vendimit nr. 46, datë 22.5.2023, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Tiranë dhe të vendimit nr. 19 datë 1.6.2023, të Gjykatës së Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Tiranë. Rrëzimin e kërkesës së Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar për caktimin e masës së sigurimit personal ndaj shtetasit Dhionisis Alfred Beleri..."*

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023- 1313 (224), datë 25.7.2023, ka vendosur: *"Lënien në fuqi të vendimit nr. 19, datë 1.6.2023, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar"*.

Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe krimin e Organizuar, me vendimin nr. 23, datë 21.6.2023, ka vendosur: *"Miratimin e vendimit nr. 205, datë 13.5.2023 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Vlorë me ndryshimet si më poshtë vijon:*

2. *Vleftësimin e ligjshëm të arrestimit në flagrancë të kryer nga policia gjyqësore ndaj Z. Dhionisis Alfred Beleri përmes aktit procedural "Procesverbal per kapjen në flagrance. date 12.5.2023, ora 00:14."... 4. Konstatimin e paligjshëm të arrestimit në flagrancë të kryer nga policia gjyqësore ndaj Z. Dhionisis Alfred Beleri përmes aktit procedural "Procesverbal për kapjen në flagrance, date 12.05.2023, ora 09:45."...6. Mospranimin e apelit të z. Dhionisis Alfred Beleri dhe z. P.K për pjesën tjetër të shkaqeve të parashtruara.*

Kundër vendimit nr. 23, datë 21.6.2023, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, më datë 4.8.2023, kanë paraqitur rekurs personat nën hetim Dhionisis Alfred Beleri dhe P.K,



të cilët kanë kërkuar: *“Shfuqizimin e vendimit nr. 23 datë 21.6.2023, të Gjykatës së Posaçme e të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Tiranë dhe të vendimit nr. 205, datë 13.5.2023, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë. Vleftësimin të paligjshëm të arrestimit në flagrancë të shtetasve Dhionisios Alfred Beleri dhe Pandeli Kokaveshi.”*

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, më 26.09.2023, me numër vendimi Nr. 00-2023- 1530²⁰, vendosi mospranimin e rekursit të paraqitur nga personat nën hetim Dhionisios Alfred Beleri dhe P.K ndaj vendimit nr, 23, datë 21.6.2023, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Nga ana tjetër, nëse i referohemi procesit zgjedhor në lidhje me fitimin e mandatit të Z. Beleri si kryetar i bashkisë Himarë, rezulton se pas përfundimit të procesit të zgjedhjeve vendore të datës 14.05.2023, Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor nr. 88, me vendimin nr. 194, datë 16.05.2023, ka shpallur fitues z. Dhionisios (Alfred) Petro Beleri, si Kryetar i Bashkisë Himarë, të propozuar nga subjekti zgjedhor Koalicioni “Bashkë Fitojmë”²¹

Në vijim, KQZ, me vendimin nr. 611, datë 25.05.2023, ka vendosur dhënien e mandatit të Kryetarit të Bashkisë Himarë, Qarku Vlorë, Z. Dhionisios (Alfred) Petro Beleri. Ndaj këtij vendimi nuk ka pasur asnjë kërkesë ankimore.

Ligji nr. 139/2015, i ndryshuar, në pikën 1, të Nenit 60 “Mandati i kryetarit të bashkisë” të tij, parashikon se: *“Mandati i kryetarit të bashkisë vërtetohet nga gjykata e rrethit gjyqësor, (dhoma civile) në juridiksionin e së cilës përfshihet bashkia përkatëse,*

brenda 20 ditëve nga data e shpalljes së rezultatit të zgjedhjes së tij.”

Në përputhje me këtë parashikim ligjor, bazuar në kërkesën e Z. Beleri, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, me vendimin nr. 418, datë 13.06.2023, ka vërtetuar mandatin e Kryetarit të Bashkisë Himarë Z. Dhionisios (Alfred) Petro Beleri, propozuar nga subjekti zgjedhor koalicioni “Bashkë Fitojmë” për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14.05.2023”²².

Në paragrafët 3 dhe 4 të nenit 60 të ligjit nr. 139/2015, parashikohet, që mandati i kryetarit të bashkisë shpallet i vlefshëm në mbledhjen më të parë të Këshillit Bashkiak përkatës dhe se ushtrimi i mandatit fillon në çastin kur bëhet betimi²³. Sipas këtyre dispozitave, Z. Beleri, ndaj të cilit ishte vendosur masa e sigurimit “arrest në burg”, ndodhej në kushtet kur mandati i tij nuk ishte shpallur ende i vlefshëm nga Këshilli Bashkiak si dhe mandati si kryetar bashkie nuk kishte filluar përsa kohë që nuk ishte kryer betimi.

Me qëllim marrjen e detyrës së Kryetarit të Bashkisë, Z. Beleri duhej të kryente betimin e tij para Këshillit të Bashkisë Himarë. Këshilli Bashkiak Himarë e ka njoftuar Z. Beleri, me cilësinë e Kryetarit të zgjedhur për zhvillimin e mbledhjes së parë të Këshillit Bashkiak Himarë, ku në rendin e ditës ishte parashikuar dhe ceremonia e marrjes së detyrës së Kryetarit të Bashkisë Himarë²⁴

Ndodhur në këto kushte, Z. Beleri ka paraqitur kërkesë pranë Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP), duke kërkuar autorizim për leje të veçantë në bazë të parashikimeve të


²⁰ http://www.gjykataelarte.gov.al/gjl_ceshtje_detaje.php?caseld_sel=2023-01317&ln=Lng1&uni=20231215141603791061232235032321

²¹ https://kqz.gov.al/wp-content/uploads/2023/05/Vendim-nr.-611-date-25.5.2023_Per-dhenien-e-mandatit-Kryetarit-te-Bashkise-Himare-Z.-Dhionisios-Beleri-BF.pdf

²² Vendim nr. 418, datë 13.06.2023, i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë. https://shqiptarja.com/uploads/ckeditor/655786219084e00-2023-1810_001.pdf

²³ Në Nenin 60, paragrafët 3 dhe 4 të ligjit nr. 139/2015 parashikohet: *“3. Shpallja e vlefshmërisë së mandatit të kryetarit të bashkisë bëhet në mbledhjen më të parë të këshillit bashkiak përkatës, ku kryetari bën betimin, sipas formulës së përcaktuar në nenin 50, të këtij ligji, dhe e nënshkruan atë. Ushtrimi i mandatit të kryetarit të bashkisë fillon në çastin kur bën betimin dhe përfundon kur bën betimin kryetari pasardhës.”*

²⁴ Vendim nr. 266, datë 26.06.2023 i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ku rezulton se Këshilli Bashkiak, Bashkia Himarë me shkresën nr. 2850/22 prot., datë 21.06.2023 më lëndë *“Njoftim për zhvillimin e mbledhjes së parë të Këshillit Bashkiak dhe marrjes së detyrës së Kryetarit të Bashkisë”* ka njoftuar Z. Beleri në cilësinë e Kryetarit të zgjedhur të Bashkisë Himarë.



RAPORT MONITORIMI

TRANSPARENCA E 10 BASHKIVE DHE MATJA E 40 PREMTIMEVE TË KRYEBASHKIAKVE

ligjit nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, me qëllim sigurimin e pjesëmarrjes së tij në mbledhjen e Këshillit Bashkiak Himarë të datës 27.06.2023.

Pretendimet e Z. Beleri bazohen në faktin se ai gëzon të gjitha të drejtat të cilat nuk i janë kufizuar me vendimin me të cilin është caktuar masa e sigurimit “arrest në burg” ndaj tij dhe në bazë të vendimeve gjyqësore nuk rezulton që ndaj tij të jetë marrë masë sigurimi ndaluese apo t’i jetë ndaluar e drejta për t’u zgjedhur.²⁵

Në datën 26.06.2023 Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka vendosur rrëzimin e kërkesës së mësipërme të Z. Beleri²⁶ me shkakun se kërkesa për leje të veçantë nuk parashikohet në ligj.²⁷

Z. Beleri, iu drejtua Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë me kërkesë për autorizim, për të marrë pjesë në mbledhjen e Këshillit Bashkiak Himarë, i cili zhvillohej në datën 27.06.2023. Gjykata në vendimin e saj u shpreh për rrëzimin e kërkesës, me argumentin se kërkesa është e pambështetur në ligj, konkretisht në nenet 8 dhe 73 të ligjit nr. 81/2020.

Gjykata në arsyetimin e saj ka parashtruar se në rastin konkret nuk është gjykata autoriteti kompetent që disponon për dhënien e lejes së kërkuar nga Z. Beleri, pasi sipas ligjit të posaçëm që ka disiplinuar procedurën që ndiqet në rastin kur kërkohet dhënia e lejes së veçantë, parashikohet që kjo leje jepet nga drejtori i institucionit me pëlqimin paraprak të prokurorit.²⁸

Z. Beleri ka bërë kërkesa për autorizim edhe në raste të tjera pranë IEVP-së/Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, respektivisht për mbledhjet e Këshillit të Bashkisë Himarë të caktuar në datat 28.07.2023 dhe 24.08.2023, ku kërkesa për mbledhjen e datës 28.07.2023 është refuzuar ndërsa ajo për mbledhjen e datës 24.08.2023 nuk ka marrë përgjigje.²⁹

Në datën 06.09.2023, Z. Beleri ka paraqitur kërkesë në bazë të nenit 73, të ligjit nr. 81/2020 për dhënien e lejes/autorizimit të veçantë pranë IEVP dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, me qëllim që pas shqyrtimit të kërkesës të kërkojë të caktohet një datë për zhvillimin e ceremonisë së betimit në Këshillin e Bashkisë Himarë. Z. Beleri ka arsyetuar se ekziston precedent edhe për dy raste të mëparshme për dhënie “autorizimi për leje të veçantë” ku personat kanë qenë nën masën e sigurimit “arrest me burg”, ish deputetin Azgan Haklaj dhe Mark Frroku.

Në përgjigjen e dhënë nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve me shkresën nr. 1938 prot., datë 08.09.2023, kërkesa e Z. Beleri është rrëzuar duke konfirmuar qëndrimin ligjor të shprehur me shkresën e datës 26.06.2023 dhe që është trajtuar edhe në vendimin nr. 266, datë 26.06.2023 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë.³⁰

Z. Beleri ka kundërshtuar këtë akt në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë duke pretenduar, se refuzimi i Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve është i pabazuar në prova e ligj, pasi nuk ka asnjë

²⁵ Në nenin 8 të ligjit nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve” parashikohet: “1. Të burgosurit gëzojnë të gjitha të drejtat që nuk u janë kufizuar nëpërmjet vendimeve gjyqësore të dënimit ose të caktimit të masës së sigurisë “arrest me burg”. 2. Të drejtat e të burgosurit, sipas këtij ligji, mund të kufizohen në minimumin e nevojshëm dhe vetëm në përbushje të një qëllimi të ligjshëm në rastet dhe sipas kriterëve të parashikuara në këtë ligj. 3. Kufizimi individual i të drejtave sipas këtij neni, nuk mund të cenohet të drejtën e të burgosurit për të komunikuar me mbrojtësin e tij dhe për të paraqitur ankesa në përputhje me parashikimet e këtij ligji.”


²⁶ Shkresë me lëndë “Kthim përgjigje kërkesës për leje të veçantë”, datë 26.06.2023 e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.

²⁷ Në nenin 73 të ligjit nr. 81/2020 parashikohet: “1. I burgosuri ka të drejtë të përfitojë leje të veçantë në rast të sëmundjeve të rënda, të cilat rrezikojnë jetën e anëtarëve të familjes, të vërtetuar me raport mjekësor, ose të ngjarjeve të rëndësishme familjare, si vdekje, lindje ose martesë, si dhe në rastet e dhënies së provimeve të vetë të dënuarit. Kjo periudhë përfshihet në kohën e vuajtjes së dënimit (...).”

²⁸ Vendim nr. 266, datë 26.06.2023 i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

²⁹ Vendim nr. 371, datë 18.09.2023 i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. https://shqiptarja.com/uploads/ckeditor/655786219084e00-2023-1810_001.pdf

³⁰ Shkresë me lëndë “Kthim përgjigje”, nr akti 1938 prot., datë 08.09.2023 e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve. https://shqiptarja.com/uploads/ckeditor/655786219084e00-2023-1810_001.pdf



vendim gjyqësor që të ketë shqyrtuar dhe rrëzuar kërkesën për dhënie autorizimi/leje të veçantë.³¹

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë me vendimin nr. 371, datë 18.09.2023 ka vendosur shpalljen e moskompetencës lëndore, për gjykimin e çështjes penale me objekt "Kundërshtimin e aktit nr. 1938 prot. Datë 08.09.2023, njoftuar më datë 11.09.2023, pranimin e kërkesës për dhënie leje/ autorizimi të veçantë", si dhe dërgimin e çështjes dhe akteve bashkëlidhur pranë gjykatës kompetente në pikëpamjen lëndore dhe tokësore, Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës. Në vendimin e saj gjykata ka argumentuar se kërkesa objekt gjykimi në thelb përbën një kërkesë me natyrë administrativo-penale, sepse kërkohet investimi i gjykatës për të zgjidhur konfliktin e një të paraburgosuri me institucionin e ekzekutimit të vendimit penal ku ai po qëndron për efekt të masës së sigurimit personal shtrëngues "arrest në burg", i cili nuk lejohet të ushtrojë një nga të drejtat e tij politike. Në zbatim të nenit 80 të ligjit nr. 81/2020, kompetente për shqyrtimin e kësaj kërkesë është gjykata e vendit të ekzekutimit të vendimit penal dhe jo e gjykatës së posaçme të shkallës së parë.³²

Në vijim të këtij vendimi, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, me vendimin nr. 137, datë 10.10.2023 vendosi t'i parashtrijë mosmarrëveshjen e kompetencës lëndore për gjykimin e kërkesës penale nr. 71029-02531-11-2023/561 regjistri themeltar, datë regjistrimi 22.09.2023, me objekt: Kundërshtimin e aktit nr. 1938 prot., datë 08.09.2023, njoftuar me datë 11.09.2023, pranimin e kërkesës për dhënie leje/ autorizimi të veçantë, Gjykatës së Lartë.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, datë 07.11.2023, me numër vendimi Nr. 00-2023-1810³³ i Vendimit, vendosi "Zgjidhjen e mosmarrëveshjes (konfliktit)

së kompetencës ndërmjet Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, duke përcaktuar si Gjykatë kompetente për gjykimin e çështjes, Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar".

Paralelisht me këto veprime, Z. Beleri ka çuar çështjen edhe në Gjykatën Kushtetuese. Më konkretisht, në datë 28.09.2023, Z. Beleri ka paraqitur kërkesë pranë Gjykatës Kushtetuese, e regjistruar me nr. 2 (Dh) 2023 regjistri themeltar, datë 28.09.2023, nëpërmjet të cilës ka kërkuar "Shfuqizimin si i papajtuësishëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimit nr. 00-2023-1313 (224), datë 25.07.2023 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, i vendimit nr. 19, datë 01.06.2023 të Gjykatës së Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe i vendimit nr. 46, datë 22.05.2023 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar"³⁴

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese në datën 23.10.2023, bazuar në nenin 21, pika 1, të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve".


Ende nuk ka një njoftim nga Gjykata Kushtetuese për datën se kur do të mbahet seanca plenare për shqyrtimin e çështjes Beleri. Për më tepër, ajo që është konstatuar gjatë fazës së mbledhjes së informacionit dhe vendimeve përkatëse të gjykatave, është mungesa e transparencës nga ana e Gjykatës Kushtetuese sa i përket njoftimit të kalimit të çështjes për shqyrtim në seancë plenare për kërkesën e Z. Beleri. I vetmi informacion është dhënë përmes

³¹ Vendim nr. 371, datë 18.09.2023 i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. https://shqiptarja.com/uploads/ckeditor/655786219084e00-2023-1810_001.pdf

³² Po aty.

³³ http://www.gjykataelarte.gov.al/gjl_ceshtje_detaje.php?caseld_sel=2023-01702&ln=Lng1&uni=20231215141603791061232235032321

³⁴ <https://shqiptarja.com/lajm/gjykata-kushtetuese-e-kalon-per-shqyrtim-dosjen-e-fredi-belerit>



RAPORT MONITORIMI

TRANSPARENCA E 10 BASHKIVE DHE MATJA E 40 PREMTIMEVE TË KRYEBASHKIAKVE

një njoftimi për shtyp, por vendimi i datës 23 nuk është bërë publik.

Ndërkaq, në datë 11.12.2023, Në Shqipëri, Gjykata e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ka rrëzuar kërkesën e kryetarit të zgjedhur të Bashkisë së Himarës Z. Beleri, për t'u pajisur me leje të posaçme për të bërë betimin pranë Këshillit Bashkiak duke evidentuar se situata konkrete në të cilën ndodhet Z. Beleri nuk parashikohet nga ligji tek rastet kur jepet leja e posaçme, pra kryerja e betimit dhe rikthimi i Z. Beleri në burg.³⁵

Në kuptim dhe interpretim të këtij vendimi të njoftuar nga GJKKO, rezulton se ekziston një vakum ligjor, i cili nëse do të ishte i adresuar me një parashikim taksativ në ligjin 81/2020, nuk do të përbënte pengesë për gjykatën për t'i akorduar Z. Belerit të drejtën e tij për të marrë leje të posaçme me qëllim kryerjen e betimit para Këshillit Bashkiak, ndërkohë që çështja penale vazhdonte shqyrtimin në themel.

Në vijim të logjikës së përdorur nga ana e Gjykatës, Z. Beleri ndodhet në kushtet kur është zgjedhur me shumicë votash nga elektorati në Himarë si kryetar bashkie, por ai nuk mundet të kryejë betimin dhe tju shërbejë interesave të qytetarëve që e kanë zgjedhur pasi ndaj tij është dhënë masa e sigurimit personal "arrest me burg" dhe sipas legjislacionit shqiptar nuk ka asnjë parashikim specifik për akordimin e lejes së posaçme përtej atyre të parashikuara në mënyrë taksative në ligjin nr. 81/2020. Në këto kushte duhet të kryhet edhe analiza se çfarë efektsh dhe pasojash krijon ky vakum ligjor dhe sa garanton mosçenimin e interesave personale të kryetarit të zgjedhur të bashkisë apo dhe interesave të zgjedhësve të cilët nuk janë të përfaqësuar.

Zgjidhja për të kapërcyer këtë vakum ligjor, por edhe për të evituar situata të ngjashme me atë të

Z. Beleri në të ardhmen, është amendimi i nenit 73 të ligjit 81/2020, dhe miratimi i tij sa më parë nga legjislatori në kushtet e ekzistencës së vullnetit, qoftë edhe me procedurë të përshpejtuar, si alternativë.

Kjo nuk do të paragjykonte në asnjë rast ecurinë e procesit penal ndaj tij. Në cdo rast, referuar edhe nenit 30 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, kushdo quhet i pafajshëm përderisa nuk i është provuar pafajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë.³⁶

Çështja Beleri është një ndër çështjet më të politizuara ndërkombëtarisht, duke i vendosur Shqipërisë një barrë të madhe për të kaluar. Greqia, që prej fillimit të procesit gjyqësor ndaj Z. Beleri ka kërkuar nga Shqipëria respektim të të drejtës për t'u betuar të kryetarit të zgjedhur të bashkisë Himarë, dhe ka kërcënuar me vendosje të vetos bllokuese në hapjen e kapitujve të parë negociues midis Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian. Në datë, 13.12.2023, kur u mbajt Samiti BE-Ballkan Perëndimor³⁷, duke vendosur veton, çka solli "ndëshkimin" e Shqipërisë, pasi BE nuk caktoi një datë për hapjen e kapitujve të Grupit të "Themeloreve".

Procedura e ndjekur nga prokuroria dhe ping-pong-u i kalimit të çështjes sa në një gjykatë në tjetrën krijon perceptimin se i gjithë procesi penal mund të ketë qenë i "infektuar" apo nën presion politik. Kjo situatë ul besimin e publikut në sistemin e drejtësisë, sidomos me rezultatin dhe koston që prodhoi për Shqipërinë dhe hapjen e negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian.

Për shkak të mbajtjes në qeli të kryetarit të zgjedhur të Himarës, Fredi Beleri i cili nuk u lejua të kryejë betimin për të marrë zyrtarisht mandatin, Jorgo Goro ka vijuar të qëndrojë në krye të bashkisë.

³⁵ <https://www.zeriamerikes.com/a/7393246.html>

³⁶ *Sipas nenit 30 të Kushtetutës, kushdo quhet i pafajshëm përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë. Prezumimi i pafajësisë përbëhet nga disa aspekte, njëri prej të cilëve është in dubio pro reo, pra çdo dyshim shkon në favor të të pandehurit dhe barra e provës bie kryesisht mbi organin e akuzës.*

³⁷ <https://top-channel.tv/video/beleri-bllokon-integrimin-be-nuk-hap-kapitujt-me-shqiperine-breaking-top-news/>

GJETJET PËR SECILËN PREJ BASHKIVE

BASHKIA ELBASAN


Premtimi	Komente	Statusi
Rindërtimi i shkollës "Jonuz Carciu" dhe rindërtimi i shkollës 9-vjeçare "Naim Frashëri"	Për të tretin vit radhazi, Bashkia Elbasan mbetet në pritje të financimit nga buxheti i shtetit, duke qenë se, sipas përgjigjes së tyre, "për shkak të kostos së lartë të preventivit është e pamundur që këto projekte të financohen nga buxheti i Bashkisë Elbasan.	Premtim i pambajtur
Ndërtimi i pikës së grumbullimit të frutave në Shushicë, Bradashesh	Bashkia në përgjigjen e saj theksoi vetëm që "është menduar të ngrihet një pikë grumbullimi për frutat në njësinë administrative Shushicë, në vendin e quajtur ish-qendra e rezervave të shtetit.	Premtim i pambajtur
Ndërtimi i rrugës së Funarit	Zbatimi i projektit do të nisë pas përfundimit të procedurës së prokurimit.	Premtim i pambajtur
Pastrimi i përroit të Shushicës.	Bashkia pranon se "investimi i fundit është bërë në Janar 2022 nga mjetet e ASHP dhe nuk ka patur investime të tjera që nga ajo kohë"	Premtim i pambajtur

BASHKIA LEZHË

Premtimi	Komente	Statusi
Rindërtimi i Pallatit të Kulturës "Dedë Ndue Lazri"	Më 19 dhjetor, Pallati i Kulturës "Dedë Ndue Lazri" në Lezhë rihapi dyert për artistët dhe publikun me një ceremoni të veçantë.	Premtim i mbajtur
Ndërtimi i Rrugës së Tales	Në investimin e fundit, 2.7 kilometrave të rrugës kryesore të Tales ishte shtuar në njërin anë një trotuar dhe ndriçues. Ndërsa, rruga lidhëse me plazhin e Tales me gjatësi 550 metra ishte bërë nga e para	Premtim i mbajtur
Projekti "Dua të luaj"	Pjesa e parkut me lodra, përfshi fushat sportive, kishin përfunduar deri në Nëntor 2023. Por sërish, vendi ishte i rrethuar ende si kantier pasi platforma mbi lumin Drin nuk kishte përfunduar.	Premtim pjesërisht i mbajtur
Rindërtimi i Pallatit në lagjen "Besëlidhja"	Rindërtimi ende s'ka nisur, ndonëse objekti u shemb dy vite më parë.	Premtim i pambajtur

BASHKIA SHKODËR

Premtimi	Komente	Statusi
Tregu në lagjen Rus në Shkodër	Ky projekt është në procedurat e tenderimit.	Premtim pjesërisht i mbajtur
Rehabilitimi i rrugëve Bërdic-Bahcallëk dhe rruga Shirokë-Zogaj	Bashkia Shkodër ka miratuar lejen e Infrastrukturës që në Vitin 2022. Ndërkohë FSHZH (zbatuesi) pohon se është në pritje të dy lejeve të tjera. (leje mjedisore+leje ndërtimi)	Premtim i pambajtur
Moli i ri në Shkodër	Është në proces realizimi i pilotave dhe ka filluar ndërtimi i traut dhe murit mbi pilota, që do të shërbejë si mur rrethues i molit. Po ashtu, janë drejt përfundimit punimet për kolektorin kryesor të shkarkimit të ujrave të ndotura dhe punimet për ndërtimin e pusetave të kontrollit.	Premtim pjesërisht i mbajtur
Aksioni për lirimin e hapësirave publike	Bashkia Shkodër ka krijuar grupe pune mes përgjegjësve për tregjet, policisë bashkiake, administratorëve të rajoneve që po identifikojnë hapësira të mundshme për t'i kthyer në tregje por ky aksion do të vazhdojë.	Premtim pjesërisht i mbajtur



RAPORT MONITORIMI

TRANSPARENCA E 10 BASHKIVE DHE MATJA E 40 PREMTIMEVE TË KRYEBASHKIAKVE

BASHKIA KORÇË


Premtimi	Komente	Statusi
Rehabilitimi i rrugëve Lekas-Voskopojë dhe Voskopojë-Krushovë	Nga verifikimet e bëra në terren, rezulton se një pjesë e rrugës (Rruga për në fshatin që i varet faqes së malit të Ostrovicës) vazhdon të jetë e pashtruar.	Premtim pjesërisht i mbajtur
Zgjidhja e situatës për ujrat e ndotura në Melçan	Rrjeti i kanalizimeve ka lënë pa përfshirë banesat e lagjes së 'Përtemit'.	Premtim pjesërisht i mbajtur
Ndërtimi i një resorti dimëror - SKIPISTA	Bashkia e Korçës pranoi për Fakte se ende nuk ka gjetur mënyrën e financimit të këtij projekti. Madje nuk ka të përcaktuar as vendndodhjen e Resortit Dimëror bashkë me Pistën e Skive.	Premtim i pambajtur
Ndërtimi i një aeroporti turistik dhe sportiv në Korçë	Në fshatin Lumamas, ku do të ndërtohet aeroporti, ka shenja nga punimet por janë ende shumë larg aeroportit që është prezantuar në videot 3D	Premtim i pambajtur

BASHKIA DIBËR

Premtimi	Komente	Statusi
Premtime për asfaltim rrugësh (Lagja Lekaçe)	Kanë përfunduar punimet për asfaltimin e rrugës në lagjen Laçe. Vlera e investimit është 45,270,928 lekë me TVSH.	Premtim i mbajtur
Asfaltimi i rrugës së Brestit të sipërm	Bashkia e Dibrës pohon se nuk ka nisur puna për ndërtimin e rrugës, sepse projekti është në fazë tenderimi.	Premtim i pambajtur
Vaditja e 500 ha toka bujqësore në Maqellarë	Bashkia e Dibrës thekson se aktualisht janë në fazën e hartimit të projektit dhe se nuk ka ndonjë afat për nisjen e tij.	Premtim i pambajtur
Fasadat e qytetit	Investimi prej 151 milionë lekësh ka përfunduar në disa lagje dhe aktualisht vijon puna në rrugën "Gjok Doçi" të qytetit.	Premtim i mbajtur

BASHKIA DURRËS

Premtimi	Komente	Statusi
Ndërtimi i godinës së parkingut publik në qendër të qytetit	Punimet kanë nisur, edhe pse me vonesë dhe mbetet për t'u vërtetuar nëse do të përmbyllet në Prill 2024 siç parashikohet në kontratë.	Premtim pjesërisht i mbajtur
Shtimi i dy rrugëve në Sukth	Ka përfunduar rikonstruksioni i dy rrugëve të premtuara në Bashkinë Sukth.	Premtim i mbajtur
Rikonstruksioni i Qendrës Kulturore për Fëmijë/QKF-së	QKF në Durrës i është nështruar rikonstruksionit prej muajit maj, por ende nuk ka përfunduar, edhe pse afati i projektit ishte 4 muaj.	Premtim pjesërisht i mbajtur
Rehabilitimi i pallateve të viteve 90' si modeli i lagjes 18.	36 familje në lagjen Nr. 5 presin prej muajsh hedhjen e shortit për apartamentin, 4 vite nga tërmeti i Nëntorit.	Premtim i pambajtur



BASHKIA KAVAJË


Premtimi	Komente	Statusi
Bonuse mujore në vlerën 5,000 ALL për çdo lindje të re	Bashkia konfirmon se bonusi prej 5 mijë lekësh në muaj nuk është shpërndarë për asnjë nga familjet që ka sjellë në jetë bebe pas zgjedhjeve vendore.	Premtim i pambajtur
Pastrimi i menjëhershëm në qytet	Bashkia e Kavajës nuk ka kthyer asnjë përgjigje në lidhje me kohën dhe periodicitetin e kryerjes së pastrimit në qytet.	Premtim i pambajtur
Ndërtimi i Parkut Rekreativ të Kavajës	Parku është i mbuluar nga mbetjet, mungojnë stolat dhe gjelbërimi. Bashkia e Kavajës pranon zyrtarisht se ende nuk është mbyllur procesi për nisjen e punimeve.	Premtim i pambajtur
Zgjidhja përfundimtare e çështjes së ujit (Fshati Karpen dhe Rrakull)	Projekti është ende në fazë hartimi	Premtim i pambajtur

BASHKIA FIER

Premtimi	Komente	Statusi
Ndërtimi i një tregu bashkëkohor për tregëtimin me shumicë të produkteve bujqësore.	Bashkia Fier është në fazë studimi për ngritjen e një tregu bashkëkohor të produkteve bujqësore.	Premtim i pambajtur
Përfundimi i rehabilitimit të qendrës së Libofshës	Bashkia e Fierit pranon për Faktojen, se për qendrën e Libofshës ende nuk ka një financim.	Premtim i pambajtur
Ndërtimi i rrugës nga Manastiri i Ardenicës deri në kishën e shëngjergjit në Libofshë.	Sipas konfirmimit të Bashkisë Fier, hartimi i planit për rikonstruksionin e rrugës kushtëzohet nga "Rehabilitimi i qendrës së Libofshës", projekt që nuk ka nisur ende.	Premtim i pambajtur
Përfundimi për rehabilitimin e infrastrukturës rrugore në njësinë Levan & përfundimi i punës për rehabilitimin e sistemit kullues;	Sipas Bashkisë Fier, Rehabilitimi i infrastrukturës rrugore në Njësinë Administrative Levan ka filluar që në vitin 2015 dhe do të vazhdojë deri në vitin 2030".	Premtim pjesërisht i mbajtur

BASHKIA VLORË

Premtimi	Komente	Statusi
Pastrimi i qytetit	Bashkia e Vlorës pohon se nuk janë shtuar ende koshat e mbeturinave.	Premtim i pambajtur
Ndërtimi i terminalit të autobusëve ndërqytetas	Bashkia e Vlorës informon se është hartuar një projekt ide, por aktualisht nuk ka një projekt zbatimi të miratuar për terminalin e autobusëve.	Premtim i pambajtur
Qendra ditore për të moshuarit në çdo rajon të qytetit.	Qendra ditore ekzistuese për të moshuarit punon vetëm tri herë në javë deri në orën 13:00 duke qëndruar më shumë e mbyllur sesa e hapur gjatë javës.	Premtim i pambajtur
Rikualifikimi i tregjeve të qytetit.	Bashkia informon se është në fazën e studimit të fizibilitetit për rikonstruksionin e tregjeve.	Premtim i pambajtur



RAPORT MONITORIMI

TRANSPARENCA E 10 BASHKIVE DHE MATJA E 40 PREMTIMEVE TË KRYEBASHKIAKVE

BASHKIA HIMARË

Premtimi	Komente	Statusi
Garantimi i ujit 24 orë për qytetin e Himarës	Premtimin për ujësjellësin e ri të Himarës mund ta konsiderojmë deri tani pjesërisht të mbajtur.	Premtim pjesërisht i mbajtur
Ndërtimi i rrugës në fshatin Tërbaç	Bashkia Himarë e ka projektin e rrugës që çon në fshatin Tërbaç, por ende nuk ka gjetur financim	Premtim pjesërisht i mbajtur
Ndërtimi i rrugës në fshatin Kudhë	Në mungesë të një plani konkret për investimet infrastrukturore, premtimin e konsiderojmë të pambajtur	Premtim i pambajtur
Rikonstruksioni i rrugës së vjetër në Pilur	Bashkia Himarë ka zhvilluar procedurën e tenderit si dhe ka shpallur fituesin por puna nuk ka nisur ende.	Premtim i pambajtur

FONDI SOCIAL

Avantazhet e përfitimit:


- Fondi social ka si qëllim ofrimin e mbështetjes financiare për njësitë e qeverisjes vendore për përmirësimin e standardeve e të kapaciteteve administruese të shërbimeve ekzistuese të kujdesit shoqëror, krijimin e shërbimeve të reja, si dhe për zhvillimin e politikave sociale në bashki.
- Nëpërmjet alokimit të Fondit Social, bashkive ju jepet mundësia të ngrejne shërbime shoqërore në territor për grupet në nevojë duke garantuar shërbimet shoqërore minimale (shporta e shërbimeve) si dhe qëndrueshmëri të shërbimeve aktuale sipas nevojave të territorit të specifikuar në Planin Social Vendor.
- Nëpërmjet fondit social, bashkitë kanë mundësi të ndërtojnë partneritete të qëndrueshme me shoqërinë civile duke bashkëpunuar për rritjen e cilësisë së ofrimit të shërbimeve dhe për garantimin e mbrojtjes sociale për të gjitha grupet vulnerabël, në kuadër të një marrëveshjeje financimi midis MSHMS dhe Bashkive në rast të përfitimit nga Fondi Social.

Problematikat kryesore:

- Në faqen zyrtare të MSHMS si dhe Shërbimit Social Shtetëror nuk gjendet asnjë informacion lidhur me projektet e financuara çdo vit nga Fondi Social, bashkitë përfituese, vlera e alokuar për secilin vit dhe nivelin e realizimit të projektit. Me qëllim rritjen e transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve përgjegjëse në nivel qendror por dhe bashkive në nivel vendor, rekomandohet që ky informacion të publikohet në mënyrë

të rregullt në faqen zyrtare të Ministrisë edhe Bashkive lidhur me financimin nga Fondi Social.

- Kuadri ligjor në fuqi, më specifikisht ligji Nr. 121/2016 **“Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”** parashikon ngritjen dhe funksionimin e Fondit Social si në nivel qendror (nivel Ministrie) ashtu edhe në nivel bashkie. Ndërkohë që aktet nënligjore si VKM Nr. 111 datë 23.2.2018, apo dhe në VKM Nr. 150 datë 20.3.2019 që përcakton funksionimin e mekanizmit financiar për financimin e fondit social, ka boshllëk ligjor sa i përket udhëzimeve specifike se si duhet të ngrihet dhe administrohet fondi social në nivel bashkie. Për të adresuar këtë mangësi, rekomandohet të rishikohet VKM nr.111/2018 me qëllim që të parashikohet ngritja dhe funksionimi i fondit social jo vetëm në nivel qendror, por edhe në nivel bashkie.
- Bashkitë, veçanërisht ato të vogla, kanë vështirësi në zbatimin e rregullave të prokurimit publik dhe mungojnë kapacitetet për kryerjen e procedurave të tilla. Kjo mund të ketë efekte negative në përdorimin dhe administrimin e Fondit Social.
- Procedurat e prokurimit për shërbimet e kujdesit shoqëror paraqesin disa sfida për bashkitë. Një nga çështjet që kërkon vëmendje është mundësia që ligjvënësi parashikon për NJQV-të për rezervimin e të drejtës së pjesëmarrjes në procedurat e prokurimit publik organizatave të caktuara për dhënien e kontratave publike për shërbime të veçanta të kujdesit shoqëror. Pavarësisht kësaj mundësie, VKM 768/2021 parashikon disa kritere që duhet të plotësojë



RAPORT MONITORIMI

TRANSPARENCA E 10 BASHKIVE DHE MATJA E 40 PREMTIMEVE TË KRYEBASHKIAKVE

organizata për pjesëmarrjen në këto procedura prokurimi. Një nga këto kritere kufizuese parashikon se organizata nuk duhet të jetë shpallur fituese e një kontrate të ofrimit të shërbimeve shoqërore gjatë tre viteve të fundit. Duke marrë parasysh që në nivel vendor, sidomos në bashki të vogla, prezenca e OJF-ve të specializuara në ofrimin e shërbimeve të caktuara shoqërore është e kufizuar, ky parashikim i vendos bashkitë në vështirësi në zbatimin në praktikë të legjislacionit të prokurimeve publike për vënien në përdorim të Fondit Social. Për të adresuar këtë problematikë, është e udhës që të rishikohet VKM 768/2021 lidhur me kufizimin e afatit të përfitimit të organizatave nëse ato kanë qenë fituese në tre vitet e fundit.

- Gjithashtu, përjashtimi i parashikuar në VKM 768/2021 lidhur me mungesën e zhvillimit të procedurave të prokurimit për shërbime, vlera e financimit të cilave gjatë një viti financiar nuk i kalon 20.000.000 lekë, i ka vënë në vështirësi bashkitë lidhur me zbatimin në praktikë të këtij përjashtimi dhe ka kirjuar konfuzion e paqartësi se cila është procedura e duhur e prokurimit për tu përdorur. Për të adresuar këto problematika, rekomandohet që të rriten dhe forcohen burimet dhe kapacitetet njerëzore në bashki dhe ofrimi i asistencës teknike lidhur me procedurat e prokurimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror.

Në datë 5 korrik 2023, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka miratuar financimin për 12 bashki, të cilat do të përfitojnë me projektet e vitit 2023, nëpërmjet Fondit Social për zgjerimin e shërbimeve sociale në territor. Për këtë qëllim janë firmosur marrëveshjet e bashkëpunimit mes Shërbimit Social Shtetëror dhe 12 Kryetarëve të Bashkive³⁸ për monitorimin e shërbimeve që do të financohen në vitin 2023 nëpërmjet Fondit Social.

Ministrja e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale gjatë aktivitetit të nënshkrimit të marrëveshjeve garanto

mbështetjen e qeverisë qendrore ndaj bashkive me qëllim përfshirjen në planet sociale vendore të më shumë shërbimeve për shtresat në nevojë. Fondi Sociali për vitin 2023 pësoi një rritje prej 30% duke duke arritur në një mbështetje për të gjitha bashkitë në 300 milion lekë në vit³⁹.

Faktoje me qëllim evidentimin e shumës së përfituar nga Fondi Social si dhe periudhën e mbështetjes të bashkive në monitorim (Dibër, Durrës, Elbasan, Fier, Himarë, Kavajë, Korçë, Lezhë, Shkodër dhe Vlorë) kërkoi informacion pranë bashkive si dhe pranë Shërbimit Social Shtetëror. Në ballafaqim të informacionit të mbledhur rezultoi se nga të gjitha bashkitë nën monitorim, vetëm bashkia Himarë, nuk ka qenë asnjëherë përfituese në programin e fondit social.

Ndërkohë që:


Bashkia Dibër ka qenë përfituese në vitin 2020, por nuk i ka përdorur fondet, pasi nuk ka arritur ta zbatojë shërbimin për shkak të gjendjes së pandemisë COVID - 19.

Bashkia Kavajë ka qenë përfituese në programin e Fondit Social në vitin 2021. (ka përfituar vetëm 1 vit pasi projekti ka qenë për 12 muaj). Vlera e akorduar nga fondi social ka qenë në vlerën 2,380,000 lekë.

- Bashkia Durrës është përfituese në programin e Fondit Social prej vitit 2020 dhe në vijim, 2020-2024.
- Bashkia Lezhë është përfituese në programin e Fondit Social prej vitit 2020 dhe në vijim, 2020-2024.
- Bashkia Elbasan është përfituese në programin e Fondit Social prej vitit 2020 dhe në vijim 2020-2024.
- Bashkia Korçë është përfituese në programin e Fondit Social prej vitit 2021 dhe në vijim 2021-2024.

³⁸ Bashkia Bulqizë, Cërrik, Fier, Gramsh, Kamëz, Klos, Lezhë, Maliq, Pogradec, Polican, Pukë dhe Selenicë

³⁹ <https://www.oranews.tv/newsmobile/1097029/>



- Bashkia Vlorë është përfituese në programin e Fondit Social prej vitit 2021 dhe në vijim 2021-2024.
- Bashkia Shkodër është përfituese në programin e Fondit Social prej viti 2022 dhe në vijim 2022-2024.

Sa i përket shumave të akorduara për secilën bashki në përputhje me skemën 90%-60%-30%, më poshtë gjendet informacioni i organizuar në formë tabelare ku përcaktohet bashkia, projekti dhe sa ka qenë financimi për vitin 2023 në raport me vitin e zbatimit të projekteve.


Financimin për vitin 2023 në masën 90 %, nga bashkitë nën monitorim, e ka përfituar bashkia Lezhë për shërbime komunitare cilësore multifunkionale me bazë komunitare, në vlerën prej 2,201,108 lekë për vitin e parë të zbatimit të projektit si dhe bashkia Fier për shërbime komunitare dhe zhvillimi

i shërbimeve cilësore multifunkionale me bazë komunitare me vlerën 2,383,160 lekë për vitin e parë të zbatimit të projektit.

Bazuar në informacionin e përcjellë nga bashkia Lezhë, rezulton se kjo e fundit ka qenë përfituese e Fondit Social në vitin 2023 për zbatimin e projektit për shërbime komunitare cilësore multifunkionale me bazë komunitare. Ky projekt do të zbatohet për një periudhë 3-vjeçare. Për këtë periudhë, vlera e fondit në total është 8,703,080 lekë. Shpërndarja e fondit sipas viteve është si më poshtë vijon:

Për vitin 2023 që korrespondon me vitin e parë të zbatimit të projektit, fondi është parashikuar 4,402,217 lekë; Duke qenë se fillimi i zbatimit të projektit është shtyrë për 6-mujorin e dytë të vitit 2023 financimi për projektin është bërë për periudhën (Qershor-Dhjetor 2023) përkatësisht në vlerën 2.201.108 lekë. Kjo shumë përputhet me vlerën e përcjellë nga Shërbimi Social Shtetëror.

Nr.	Bashkia	Titulli i projektit	Financim për vitin 2023 në masën 90% për 6 muaj	Viti i zbatimit
1	Poliçan	Qendër Sociale Ditore.	2,653,952	I
2	Selenicë	Shërbim lëvizës për PAK	1,780,000	I
3	Gramsh	Shërbimi i specializuar për fëmijë e të rinj me Aftësi të Kufizuar në familje dhe në Qëndrën ditore në Bashkinë Gramsh	2,632,000	I
4	Bulqizë	Shërbimi i specializuar për fëmijë e të rinj me Aftësi të Kufizuar në familje dhe në Qëndrën ditore në Bashkinë Bulqizë	2,605,000	I
5	Klos	Shërbimeve sociale për komunitetet në nevojë	1,938,000	I
6	Maliq	Shërbime mbështetëse dhe fuqizuese në familje dhe PAK - Shërbime levizëse pranë Qendres Komunitare Maliq	1,618,348	I
7	Fier	Shërbime komunitare dhe zhvillimi i shërbime cilësore multifunkionale me bazë komunitare.	2,383,160	I
8	Kamëz	Qendra Multifunkionale Komunitare	4,368,903	I
9	Cërrik	Shërbim multifunkionale me bazë komunitare.	1,576,974	I
10	Pukë	Shërbime të përkujdesit social ditor për të moshuarit në bashkinë Pukë.	1,021,800	I
11	Lezhë	Shërbime komunitare cilësore multifunkionale me bazë komunitare.	2,201,108	I
12	Pogradec	Shërbime mbështetëse fizioterapie - psikosociale për PAK (para-tetraplegjik) - shërbime rehabilituese ditore	944,256	I



RAPORT MONITORIMI

TRANSPARENCA E 10 BASHKIVE DHE MATJA E 40 PREMTIMEVE TË KRYEBASHKIAKVE

Nr.	Bashkia	Tipologjia e shërbimit	Financimi për vitin 2023 në masën 60%	Viti i zbatimit
1	Patos	“Shërbim në familje për personat me aftësi të kufizuara të shëndetit mendor në Bashkinë Patos”	1,244,000	II
2	Delvinë	Qendra Ditore për të moshuarit	2,609,800	II
3	Shkodër	Familje për çdo bashki (strehëz për fëmijët pa kujdes prindëror)	8,612,016	II
4	Sarandë	Qendër multifunkionale për zhvillimin e fëmijëve dhe fuqizimin e familjes	4,124,972	II
5	Kolonjë	Qendra ditore për të moshën e tretë	3,523,152	II
6	Tepelenë	Shërbim lëvizës komunitar moshë e tretë “Gjithmonë bashkë”	3,630,240	II
7	Devoll	Shërbimeve sociale të lëvizshme	2,402,667	II
8	Malësia e Madhe	Kujdesi në banesë për të moshuarit	1,830,000	II
9	Roskovec	Shërbim ditor për të moshuar	1,156,050	II

Për vitin 2024, që korrespondon me vitin e dytë të zbatimit të projektit, fondi i parashikuar në masën 60 % nga MSHMS është 2,729,299 lekë;

Për vitin e tretë të zbatimit të projektit 2025, fondi i parashikuar në masën 30 %, nga MSHMS është 1,571,564 lekë;

Përsa i përket bashkisë Fier, referuar informacionit të përcjellë nga kjo bashki, rezulton se kjo e fundit ka qenë përfituese e Fondit Social në datë 06.07.2023, ku Shërbimi Social Shtetëror ka dërguar akordimin e fondeve për financim për ofrimin e shërbimeve të përkujdesit shoqëror në nivel Qarku dhe Bashkie. Për periudhën tre vjeçare vlera e fondit në total është 9,431,288 lekë. Nga informacioni i vënë në dispozicion nga bashkia është e vështirë të kuptohet shpërndarja e financimit për të gjithë periudhën e zbatimit të projektit, sipas viteve.

Financim për vitin e dytë të zbatimit të projekteve për vitin 2023 në masën 60% e ka përfituar bashkia Shkodër me vlerë projekti 8,612.016 Lekë për vitin e dytë të zbatimit të projektit.


Bashkia Shkodër ka aplikuar pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për fondin social të vitit 2022 ku dhe ka rezultuar fituese. Që prej fillimit të vitit 2022, bashkia po mbështetet

nëpërmjet skemës së Fondit Social për një periudhë 36 mujore (janar 2022 -dhjetor 2024). Planifikimi i alokimit të fondit ndjek skemën e disbursimit (90%-60%-30%).

Financimi i vitit të parë në masë 90 % të totalit të kostove të ofrimit të shërbimit është 7,841.995 lekë. Kjo shumë përkon me 7 muaj shërbim duke qenë se alokimi është kryer në muajin maj 2022. Viti i dytë financohet me 60% të vlerës së projektit 8,612.016 Lekë. Viti i tretë do të financohet në masën 30 % me shumën 4,158.672 Lekë.

Financimin për vitin 2023 në masën 30 %, nga bashkitë nën monitorim, e ka përfituar bashkia Korçë, bashkia Elbasan, bashkia Vlorë, bashkia Durrës dhe bashkia Lezhë.

Bashkia Korçë është përfituese e Fondit Social për një periudhë 3 vjeçare (2021-2024) për ngritjen e qendrës së shërbimeve mbështetëse për fëmijën dhe familjen me bazë komunitare. Vlera totale monetare e përfitimit është 13,117,740 lekë. Financimi për vitin 2023 në masën 30% për vitin e tretë të zbatimit të projektit do të ketë vlerën 3,946,724 lekë. Edhe kjo bashki nuk ka përcjellë informacion të plotë në lidhje me shpërndarjen e financimit për të gjithë periudhën e zbatimit të projektit.



Bashkia Elbasan në përgjigjen e saj ka përmendur faktin se ka qenë përfituese prej disa vitesh e skemës së Fondit Social që prej vitit 2020 me disa projekte. Një prej projekteve të zbatuar për një periudhë 3 vjeçare 2020- 2022 lidhet me ngritjen e qendres multifunksionale në Shushicë, e zbatuar në bashkëpunim me Terre de Homes. Financimi për vitin 2023 në masën 30% për vitin e tretë të zbatimit të projektit është në vlerën 1,715,945.16 lekë. Bashkia Elbasan nuk ka siguruar informacion në lidhje me vlerën e plotë të zbatimit të projektit si dhe shpërndarjen e tij për të gjithë periudhën e zbatimit.

Gjithashtu, bashkia Elbasan, nëpërmjet mbështetjes së Fondit Social ka zbatuar projektin për njësitë lëvizëse në njësitë administrative si dhe ofrimi i shërbimit në familje për fëmijët me aftësi të kufizuar. Ky projekt nuk ka arritur të zbatohet për një periudhë të gjatë për shkak të pandemisë COVID19 në vitin 2019.

Bashkia Vlorë është përfituese e Fondit Social për një periudhë 3 vjeçare (2021-2023) për financimin e shërbimit të ri mbështetës për parandalimin e institucionalizimit dhe deinstitucionalizimi i fëmijëve nga institucionet e përkujdesit shoqëror.

- Për vitin 2021, fondi i alokuar nga MSHMS ka qenë 11.682.740 lekë;
- Për vitin 2022 fondi i alokuar nga MSHMS ka qenë 8.018.188 lekë;
- Për vitin 2023, që korrespondon me financimin në masën 30 % të vlerës së projektit dhe me vitin e tretë të zbatimit të tij, fondi i alokuar nga MSHMS është 3.971.27 lekë.


Bashkia Durrës ka qenë përfituese e Fondit Social në partneritet me organizatën World Vision, për ngritjen e Qendrës Emergjente Mbrojtëse dhe fuqizuese për fëmijet dhe familjen. Ky projekt është zbatuar në vitin 2020 e në vazhdim. Fondi për 3 vjet ka qenë në total në vlerën 39.421.264 lekë, Për vitin 2023, që korrespondon me financimin në masën 30 % të vlerës së projektit dhe me vitin e katërt të zbatimit të tij, fondi i alokuar nga MSHMS është 3,536,784 lekë. Edhe kjo bashki nuk ka përcjellë informacion mbi shpërndarjen e financimit për të gjithë periudhën e zbatimit të projektit sipas viteve.

Bashkia Lezhë, referuar informacionit të përcjellë, rezulton të ketë zbatuar projektin “Shërbimi lëvizës për fëmijët me aftësi të kufizuar në Bashkinë Lezhë” i fituar në kuadër të thirrjes së parë për projekt propozime të programit të fondit social thirrje e hapur nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Ky projekt ka filluar zbatimin e tij në vitin 2020 dhe është në vitin e katërt të zbatimit të tij. Shpërndarja e fondit sipas viteve paraqitet si më poshtë vijon:

- Për vitin 2020, fondi i alokuar nga MSHMS ka qenë 3,308,760 lekë;
- Për vitin 2021, fondi i alokuar nga MSHMS ka qenë 2,931,572 lekë;
- Për vitin 2022, fondi i alokuar nga MSHMS ka qenë 1,172,000 lekë;
- Për vitin 2023, fondi i alokuar nga MSHMS ka qenë,172,000 lekë.

Ky informacion konfirmohet edhe nga ana e Shërbimit Social Shtetëror, i cili tregon se fondi për vitin 2023, që korrespondon me financimin në masën 30 % të vlerës së projektit është 1,172,000 lekë.

Nr.	Bashkia	Tipologjia e shërbimit	Financimi për vitin 2023 në masën 30%	Viti i zbatimit
1	Korcë	Qendra e Shërbimeve Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen me bazë komunitare	3,946,724	III
2	Rrogozhinë	“Tungjatjeta Jetë, Shërbim lëvizës për fëmijët me aftësi të kufizuar”, në bashkinë Rrogozhinë,	2,192,016	III
3	Kukës	Ngritja dhe Funkcionimi i strehës së emergjencës për gratë dhe vajzat e dhunuara që jetojnë në zonat rurale.	1,665,506	III



RAPORT MONITORIMI

TRANSPARENCA E 10 BASHKIVE DHE MATJA E 40 PREMTIMEVE TË KRYEBASHKIAKVE

4	Elbasan	Ngritja e shërbimeve komunitare Multifunkionale për fëmijët, të rinjtë dhe familjen në njësinë Administrative Shushicë	1,715,945.16	III
5	Vlorë	Parandalimi i institucionalizimit dhe deinstitutionalizimi i fëmijëve nga institucionet e përkujdesit shoqëror.	3,971,724	III
6	Durrës	Qendër për shërbime Mbrojtëse, Fuqizuese dhe Emergjente për Fëmijen dhe Familjen	3,536,784	IV
7	Gjirokastrë	Ofrimi i Shërbimeve për Viktimat e Dhunës me Baze Gjinore	1,987,018	IV
8	Lezha	Shërbimi Lëvizës "Tungjatjeta... Jetë" fëmijet AK	1,172,000	IV
9	Librazhdi	Shërbim i integruar komunitar për fëmijë dhe të rinj me aftësi të kufizuara, përmes programit Tungjatjeta Jetë dhe Qendrës Komunitare.	2,503,632	IV
10	Belsh	Qendër Sociale Ditore për të moshuar	1,233,900	III
11	Prrenjas	Qendra Ditore e të Moshuarve Prrenjas	2,340,000	III
12	Berat	Qendra Strehëza	1,164,000	III
13	Lushnje	Shërbimi ditor për fëmijët AK 3-6 vjeç	1,249,600	III

Nëse bëjmë një vlerësim të shpërndarjes së fondit të parashikuar në programin e Fondit Social për vitin 2023 për bashkitë në vend, rezulton se totali i shpërndarë është në vlerën 83,535,247 lekë në raport me parashikimin i cili ka qenë 300,000,000 milion lekë. Në vitin 2023 MSHMS ka ofruar mbështetje financiare për 34 shërbime në 33 bashki, në kuadër të Fondit Social.

Fondi social është një mekanizëm financiar për ngritjen dhe zgjerimin e shërbimeve sociale. Neni 47 i Ligjit nr. 121/2016⁴⁰ **"Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë"** parashikon në mënyrë të posaçme se **"Bashkia, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për çështjet sociale, krijon dhe administron fondin social, nëpërmjet të cilit sigurohet mbështetje financiare për njësitë e qeverisjes vendore"**. Ai krijohet dhe administrohet nga bashkitë në bashkëpunim me Ministrinë përgjegjëse për çështjet sociale.


Fondi social ka si qëllim ofrimin e mbështetjes financiare për njësitë e qeverisjes vendore për

përmirësimin e standardeve e të kapaciteteve administruese të shërbimeve ekzistuese të kujdesit shoqëror, krijimin e shërbimeve të reja, si dhe për zhvillimin e politikave sociale. Ai është parashikuar të mbështesë financimin për shërbimet e kujdesit shoqëror në nivel vendor dhe të mbështesë krijimin e shërbimeve të reja, në përputhje me planet e miratuara vendore të burimeve të ndryshme të financimit drejt burimeve të siguruara në nivel vendor. Financimi nga buxheti i shtetit mbështet deri në 90% të kostove për vitin e parë të ofrimit të shërbimit; deri në 60% të kostove gjatë vitit të dytë të ofrimit të shërbimit; dhe më pas 30% të kostove⁴¹.

Por deri më tani, asnjë nga bashkitë nuk ka mundur të krijojë Fondin e vet Social por ka qenë Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ajo që ka financuar për shërbime të reja në territor për mbrojtjen e menjëhershme për grupet vulnerabël. Nëpërmjet alokimit të Fondit Social, bashkive ju jepet mundësia të ngrejshë shërbime shoqërore në territor për grupet në nevojë duke garantuar shërbimet shoqërore minimale (shporta e shërbimeve) si dhe

⁴⁰ <https://qzb.gov.al/eli/ligj/2016/11/24/121-2016>

⁴¹ VKM nr. 150, datë 20.03.2019, "Për metodologjinë e llogaritjes së fondeve për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror".



qëndrueshmëri të shërbimeve aktuale sipas nevojave të territorit të specifikuar në Planin Social Vendor.

Në datë 5 korrik 2023, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka miratuar financimin për 12 bashki, të cilat do të përfitojnë me projektet e vitit 2023, nëpërmjet Fondit Social për zgjerimin e shërbimeve sociale në territor. Për këtë qëllim janë firmosur marrëveshjet e bashkëpunimit mes Shërbimit Social Shtetëror dhe 12 Kryetarëve të Bashkive⁴² për monitorimin e shërbimeve që do të financohen në vitin 2023 nëpërmjet Fondit Social.

Ministrja e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale gjatë aktivitetit të nënshkrimit të marrëveshjeve garantoj mbështetjen e qeverisë qendrore ndaj bashkive me qëllim përfshirjen në planet sociale vendore të më shumë shërbimeve për shtresat në nevojë. Fondi Sociali për vitin 2023 pësoi një rritje prej 30% duke arritur në një mbështetje për të gjitha bashkitë në 300 milion lekë në vit⁴³.

Fondi Social përbëhet nga:

- të ardhurat vjetore nga Buxheti i Shtetit;
- financime jashtëbuxhetore nga organizata vendase apo të huaja ose persona të tjerë;
- të ardhurat nga zbatimi i tarifave për shërbime të ndryshme të kujdesit shoqëror;
- të ardhurat nga burimet e veta dhe nga pasuritë që zotëron ministria përgjegjëse për çështjet sociale;
- të ardhurat nga burimet e veta dhe nga pasuritë që zotëron bashkia.

Mjetet financiare në fondin social, të papërdorura në vitin fiskal ushtrimor, mbarten në buxhetin e vitit pasardhës si pjesë e fondit social.

Duke marrë parasysh që për një kohë të gjatë, shërbimet shoqërore janë ofruar përmes sektorit jo-publik - kryesisht të financuara nga partnerët


ndërkombëtarë, OJF-të ndërkombëtare dhe organizatat lokale të cilat janë përpjekur të mbushin boshllëqet në ofrimin e shërbimeve publike, nëpërmjet fondit social, bashkitë tani kanë mundësi që nëpërmjet fondit social të ndërtojnë partneritete të qëndrueshme me shoqërinë civile duke bashkëpunuar për rritjen e cilësisë së shërbimeve dhe për garantimin e mbrojtjes sociale për të gjitha grupet vulnerabël, në kuadër të një marrëveshjeje financimi midis MSHMS dhe Bashkive në rast të përfitimit nga Fondi Social.

Për të mundësuar ngritjen dhe ofrimin e shërbimeve shoqërore, është miratuar një paketë e plotë ligjore, ku më të rëndësishmet mund të përmenden:

- Ligji Nr. 139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, ka një rol thelbësor duke i ngarkuar Njësitë të Vetëqeverisjes Vendore (NQVV) përgjegjësi dhe funksione të reja, përfshi fushën e shërbimeve të kujdesit shoqëror. Ky ligj adreson identifikimin, vlerësimin dhe planifikimin e masave për të mbuluar nevojat e komunitetit në përgjithësi dhe të grupimeve në nevojë në veçanti. Gjithashtu, ligji vendos kërkesa për planifikimin e burimeve financiare dhe bashkëpunimin shumësektorial në nivel vendor, duke përfshirë të gjithë aktorët, publikë dhe jopublikë, të angazhuar në programet dhe shërbimet e mbrojtjes sociale.
- Ligji për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror (Nr. 121/2016) përsa i përket kuadrit institucional bën një ndarje të qartë të kompetencave dhe përgjegjësisë të institucioneve përgjegjëse në fushën e shërbimeve të kujdesit shëndetësor. Ai përcakton rolin dhe kompetencat e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MShMS), si përgjegjëse për:
 - Hartimin e politikave për reformimin dhe modernizimin e sistemit të shërbimeve të kujdesit shoqëror, me synim rritjen e efektivitetit të ofrimit të tyre;

⁴² Bashkia Bulqizë, Cërrik, Fier, Gramsh, Kamëz, Klos, Lezhë, Maliq, Pogradec, Polican, Pukë dhe Selenicë


⁴³ <https://www.oranews.tv/newsmobile/1097029/>



RAPORT MONITORIMI

TRANSPARENCA E 10 BASHKIVE DHE MATJA E 40 PREMTIMEVE TË KRYEBASHKIAKVE

- Hartimin dhe përditësimin e standardeve minimale të ofrimit të shërbimeve;
- Përcaktimin e kriterëve dhe kushteve që duhet të përmbushin subjektet e ofrimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror;
- Hartimin e programit, si zë më vete në buxhet, të fondeve për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, që u delegohet bashkive si transfertë në fondin social;
- Këshillimin dhe udhëzimin e njësive të qeverisjes vendore në lidhje me strukturat që duhet të ngrihen prej tyre për zbatimin e sistemit të shërbimeve të kujdesit shoqëror dhe mënyrat e planifikimit dhe të ofrimit të shërbimeve;
- Hartimin dhe paraqitjen për miratim të nevojave për financim nga buxheti i shtetit për aktivitetet e shërbimeve të kujdesit shoqëror.
- Gjithashtu, një institucion tjetër i rëndësishëm është ai i Shërbimit Social Shtetëror, institucion në varësi të ministrisë përgjegjëse për çështjet sociale, është përgjegjës për:
 - vlerësimin e nevojave të shërbimeve të kujdesit shoqëror;
 - mbledhjen, analizën dhe përpunimin e informacionit mbi ecurinë e sistemit të shërbimeve të kujdesit shoqëror;
 - hartimin e raportit vjetor të vlerësimit të nevojave për shërbime të kujdesit shoqëror dhe kapaciteteve të shërbimeve publike e jopublike;
 - bashkërendimin e procesit të hartimit të planeve sociale, duke siguruar që këto plane të përputhen me strategjitë kombëtare;
 - përditëson dhe mirëmban Regjistrin Elektronik Kombëtar me të dhënat për përfituesit dhe subjektet kërkuese të kujdesit shoqëror etj.
- Inspektorati i Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror:
 - kontrollon zbatimin e kriterëve e të kushteve nga subjektet publike dhe jopublike që ushtrojnë veprimtari të ofrimit të shërbimeve sociale;
 - inspekton standardet e shërbimeve të ofruara nga ofruesit e shërbimeve të kujdesit shoqëror;
 - bashkëpunon dhe u jep informacion organeve të tjera shtetërore për rastet që janë në kompetencën e tyre në lidhje me veprimtarinë e ofrimit të shërbimeve të kujdesit social;
 - ushtron kontroll në mjediset dhe në dokumentacionin e subjekteve që ofrojnë shërbime të kujdesit social etj.
- Bashkia, është institucioni që ofron dhe administron shërbimet e kujdesit shoqëror brenda territorit të saj duke:
 - identifikuar dhe vlerësuar nevojat në bazë të hartës së shtresave në nevoje;
 - hartuar planin social vendor;
 - programuar buxhetet vendore;
 - planifikuar shportën bazë të shërbimeve shoqërore;
 - kontraktuar ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror me anë të procedurave të prokurimit;
 - bashkërenduar me ShSSH-në shërbimet e nevojshme të kujdesit shoqëror.
- Këshilli i qarkut ka përgjegjësi:
 - të hartojë planin social rajonal të bashkërenduar me planet sociale të njësive të qeverisjes vendore dhe ia paraqet MShMS-së.
 - Kryetari i qarkut vendos për ofrimin e shërbimeve të specializuara, duke bashkërenduar në nivel rajonal rastet për shërbimet e kujdesit shoqëror, si dhe



- Kryetari i qarkut krijon komitetin e planifikimit të nevojave "ad hoc", të përbërë nga përfaqësues të të gjitha strukturave vendore /rajonale dhe shoqërisë civile, me pjesëmarrje vullnetare.
- VKM nr. 768, datë 15.12.2021 për **"Përcaktimin e llojeve të shërbimeve sociale dhe shërbimeve të tjera specifike, llojet e shërbimeve të veçanta për të cilat mund të rezervohet e drejta e pjesëmarrjes së organizatave në procedurat e prokurimit publik, si dhe rregullat e detajuara për prokurimin e tyre"**, ju japin mundësi njësisve të vetëqeverisjes vendore të tansferojnë fonde publike tek OJF-të në përputhje me Planet Vendore Sociale për prokurimin e këtyre fondeve për ofrimin e shërbimeve shoqërore në nivel vendor në zbatim të legjislacionit në fuqi për Prokurimet Publike.

Ligji nr.121/2016 i delegon Këshillit të Ministrave (KM) dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) nxjerrjen e akteve nënligjore për ngritjen, funksionimin dhe administrimin e Fondit Social.

Bazuar në pikën 4 të nenit 47⁴⁴ të ligjit nr.121/2016, Këshilli i Ministrave miratoi Vendimin nr.111/2018 "Për krijimin dhe funksionimin e Fondit Social"⁴⁵ i cili parashikon se Fondi Social krijohet si një mekanizëm financiar nëpërmjet të cilit sigurohet mbështetje financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore për arritjen e qëllimeve të parashikuara në këtë nen.

VKM nr.111/2018 rregullon krijimin e fondit social si një mekanizëm financiar nën administrimin e MSHMS, nëpërmjet të cilit sigurohet mbështetje financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore, me qëllim përmirësimin e standardeve e të kapaciteteve administruese të shërbimeve ekzistuese të kujdesit shoqëror, planifikimin e krijimin e shërbimeve të reja, si dhe zhvillimin e politikave sociale. Pra, i gjithë procesi dhe funksionimi i mekanizmit kryhet nga

MSHMS, ndërkohë, që nuk ka rregullim në lidhje me funksionimin e këtij mekanizmi në nivel bashkie.

VKM nr.111/2018 lë një sërë detyrash për bashkitë në mënyrë që këto të fundit të përfitojnë nga mekanizmi i financimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror. Njësia e vetëqeverisjes vendore duhet të kryejë një vlerësim paraprak të nevojave për ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror në nivel vendor, në përputhje me planin strategjik të zhvillimit dhe me programin buxhetor afatmesëm. Gjithashtu, ajo duhet të vlerësojë kapacitetet financiare dhe burimet njerëzore që mbështesin ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror në nivel vendor si dhe duhet të sigurojnë vazhdueshmërinë e ofrimit të paktën atyre shërbimeve që kanë ofruar gjatë tri viteve të fundit.


Nga ana tjetër, VKM nr.111/2018 parashikon edhe mundësinë që Ministria përgjegjëse për çështjet sociale, t'u transferojë njësisve të vetëqeverisjes vendore fonde për financimin e shërbimeve të përkujdesjes shoqërore (të parashikura në buxhetin e saj), bazuar në planet sociale të buxhetuara. Në këtë kuptim, bashkitë kushtëzohen për përfundimin e këtyre fondeve nga ekzistenca e Planeve Vendore Sociale të miratuara dhe të buxhetuara.

Ashtu siç e theksuam dhe më lart, në shumicën e rasteve Bashkitë nuk kanë mundësi t'i ofrojnë vetë shërbimet e kujdesit shoqëror dhe për këtë qëllim ato kanë lidhur parteritete me organizata jofitimprurëse lokale. VKM nr.111/2018 e ka parashikuar dhe rregulluar edhe këtë aspekt duke parashikuar rastet kur Bashkitë nuk mund t'i ofrojnë vetë shërbimet e kujdesit shoqëror për të cilat kanë kërkuar mbështetje financiare përmes Fondit Social.

Referuar parashikimeve në nenin 5.1 të VKM-së, shërbimet e përkujdesjes shoqërore, të cilat konsiderohen si parësore nga bashkia, por që nuk mund të ofrohen prej saj, mund të ofrohen nga organizata jofitimprurëse, si ndërmarrje sociale apo struktura të ngjashme me to, që operojnë në

⁴⁴ Neni 47, pika 4 e ligjit 121/2016: 4. Procedurat e krijimit e të funksionimit të fondit social rregullohen dhe miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

⁴⁵ <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2018/02/23/111>



RAPORT MONITORIMI

TRANSPARENCA E 10 BASHKIVE DHE MATJA E 40 PREMTIMEVE TË KRYEBASHKIAKVE

këtë fushë private. Njësia e vetëqeverisjes vendore prokuron shërbimet e kujdesit shoqëror dhe lidh kontratat me ofruesit e shërbimit, duke u dhënë përparësi ndërmarrjeve sociale në ofrimin e këtyre shërbimeve.

Sa i përket ndjekjes së zbatimit të fondit social në ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, VKM nr.111/2018 parashikon se *“Njësia e vetëqeverisjes vendore raporton, çdo katër muaj, në lidhje me ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, financuar me anë të fondit social, pranë Shërbimit Social Shtetëror”*. Ndërkaq nuk ka asnjë rregullim specifik për mënyrën se si do të kryhet ky raportim duke qenë se raportimi do të jetë rezultat i një procesi monitorimi nga ana e NJQV-së për shërbimet e ofruara, të reja apo të përmirësuara të financuara nga Fondi Social. Për këtë paraqitet e nevojshme që të bëhen ndryshime në këtë VKM duke reflektuar këtë problematikë ose të hartohen rregulla të posaçme nga ana e Shërbimit Social Shtetëror me MSHMS mbi mënyrat e raportimit, llojet e tij, shpeshhtësinë dhe dokumentacionin etj.

Siç edhe është përmendur më lart, Njësitë e vetëqeverisjes vendore prokurojnë shërbimet e kujdesit shoqëror, në përputhje me rregullat e prokurimit publik dhe lidhin kontratat me ofruesit jopublikë/organizatat jofitimprurëse.

Legjislacioni për prokurimin e shërbimeve shoqërore përcakton: i) procedurat që ndjek njësia e qeverisjes vendore/bashkia në prokurimin e fondeve publike; ii) detyrat, rolet dhe përgjegjësitë e specialistëve që marrin pjesë në prokurim; iii) llojin e procedurës së përzgjedhur sipas vlerës së kontratës që prokurohet; iv) mënyrën e publikimit; v) vlerëson raportin cmim-cilësi për vlerësimin e propozimit më të mirë në përzgjedhjen e OJF që do të ofrojë shërbimin; vi) këkon garantimin e transparencës dhe barazisë gjatë gjithë procesit të prokurimit.

NJVQV hartojnë specifikimet teknike, bazuar në standardet e miratuara nga MSHMS për të organizuar dhe për të hapur tenderin e shërbimeve


të kujdesit shoqëror, kur ato ofrohen nga persona juridikë private. Rregullat e detajuara të prokurimit publik të shërbimeve të kujdesit shoqëror bazohen në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 768 datë 15.12.2021⁴⁶ *“Për përcaktimin e llojeve të shërbimeve sociale dhe shërbimeve të tjera specifike, llojeve të shërbimeve të veçanta, për të cilat mund të rezervohet e drejta e pjesëmarrjes së organizatave në procedurat e prokurimit publik si edhe rregullave të detajuara për prokurimin e tyre”*.

Bazuar në këtë VKM, në kryerjen e procedurave të prokurimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror, NJVQV në cilësinë e autoriteteve kontraktuese duhet të veprojë në përputhje me parimet e transparencës, trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë dhe nxitjes së konkurrencës. Prokurimi i shërbimeve shoqërore lejon transferimin e fondeve publike nga njësitë e qeverisjes vendore/bashkitë tek OJF-të, bazuar në planet sociale vendore.

Një nga nenet që kërkon vëmendje të shtuar dhe duhet analizuar është Neni 3 *“Kontrata të rezervuara për shërbime të caktuara”*. Bazuar në parashikimet e këtij neni, NJVQV në cilësinë e autoritetit kontraktues, mund t'i rezervojnë të drejtën e pjesëmarrjes në procedurat e prokurimit publik organizatave të caktuara për dhënien e kontratave publike për shërbime të veçanta të kujdesit shoqëror. Megjithatë, pavarësisht kësaj mundësie, pika 2 e Nenit 3 të VKM parashikon disa kritere që duhet të plotësojë organizata për pjesëmarrjen në procedurat e sipërpërmendura. Në mënyrë specifike, në Nenin 3/2 shkronja ç) parashikohet se organizata **nuk duhet të jetë shpallur fituese e një kontrate të ofrimit të shërbimeve shoqërore gjatë tre viteve të fundit**.

Duke marrë parasysh që në nivel vendor, sidomos në bashki të vogla, prezenca e OJF-ve të specializuara në ofrimin e shërbimeve të caktuara shoqërore është e kufizuar, ky parashikim i vendos bashkitë në vështirësi në zbatimin në praktikë të legjislacionit të prokurimeve publike për vënien në përdorim të Fondit Social. Ky lloj kufizimi mund të pozicionojë

⁴⁶ <https://www.app.gov.al/legjislacioni/prokurimi-publik/vkm/>



bashkitë, kryesisht ato të vogla për të hezitur për të aplikuar pranë MSHMS për të përfituar nga fondi social. Por kjo nga ana tjetër, sjell efekte negative dhe ka impakt të drejtpërdrejtë në sigurimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror për kategorinë në nevojë.

Një problematikë tjetër është nevoja për rritjen e kapaciteteve dhe asistimin lidhur me procedurat e prokurimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror. Mungesa e burimeve njerëzore apo kapaciteteve në nivel të NJVQV lidhur me këtë proces, ndikon në mosrealizimin me sukses të procedurave të prokurimit/ lidhjes së kontratave të financimit me pasojë mos-përdorimin e fondit social. I vetmi përjashtim i përcaktuar në VKM lidhur me mungesën e zhvillimit të procedurave të prokurimit lidhet me rastin e shërbimeve, vlera e financimit të të cilave gjatë një viti financiar nuk i kalon 20.000.000 lekë. Në çdo rast tjetër, rregullat që duhet të zbatohen nga NJVQV janë ato të parashikuara shprehimisht në VKM

nr.768/2021. Edhe për zbatimin e këtij parashikimi, NJQV-të kanë vështirësi në zbatimin në praktikë dhe janë të paqartë se cila është procedura e duhur e prokurimit për tu përdorur.

Agjensia e Prokurimit Publik (APP) në përgjigjen e dhënë Faktotje në lidhje me këtë çështje, është shprehur se shërbimet që brenda një viti kalendarik kanë një fond nën vlerën 20.000.000 lekë nuk i nënshtrohen procedurave të prokurimit dhe se AK do të kryejë procedurën duke respektuar parimet e transparencës, trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë dhe nxitjes së konkurrencës. Pra, bazuar në këtë përgjigje rezulton se bashkitë janë të detyruara të ndërtojnë një procedurë përzgjedhje për ofrimin e shërbimeve sociale duke respektuar parimet e transparencës, trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë dhe nxitjen e konkurrencës por pa ndjekur një procedurë të hapur sipas legjislacionit shqiptar për prokurimin e shërbimeve publike.

ANEKS 1

Kërkesa për informacion dërguar 10 bashkive të monitoruara

KËRKESË

11.12.2023

KËRKUES: Emër mbiemër

Adresa:

Email:

DREJTUAR: Bashkisë _____

BAZA LIGJORE:

- ◆ Neni 10 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut
- ◆ Neni 19 i Paktit Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike
- ◆ Neni 23 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë
- ◆ Ligji nr.119 dt. 18.09.2014 "Për të Drejtën e Informimit"

Në bazë të parashikimeve ligjore të akteve të renditura në bazën ligjore të mësipërme, kërkoj ju lutem informacionin dhe dokumentacionin përkatës për pyetjet më poshtë:

1 A është konsultuar me publikun Buxheti Vjetor 2020 dhe 2021 i Bashkisë? Nëse po, më përcillni kopje të njoftimit/njoftimeve për zhvillimin e dëgjësive publike, kur dhe ku është publikuar


njoftimi/njoftimet, kopje të procesverbaleve të mbajtura, kopje të rekomandimeve dhe dokumente të tjera që mbështesin realizimin e këtij procesi.

2 A është konsultuar me publikun paketa e taksave dhe tarifave vendore për periudhën 2020-2021? Nëse po, më përcillni kopje të njoftimit/njoftimeve për zhvillimin e dëgjësive publike, kur dhe ku është publikuar njoftimi/njoftimet, kopje të procesverbaleve të mbajtura, kopje të rekomandimeve dhe dokumente të tjera që mbështesin realizimin e këtij procesi.

3 A është konsultuar me publikun tjetërsimi i pronave të Bashkisë për periudhën Janar 2020-Shkurt 2021? Nëse po, më përcillni kopje të njoftimit/njoftimeve për zhvillimin e dëgjësive publike, kur dhe ku është publikuar njoftimi/njoftimet, kopje të procesverbaleve të mbajtura, kopje të rekomandimeve dhe dokumente të tjera që mbështesin realizimin e këtij procesi.

4 A janë njoftuar paraprakisht në faqen e internetit ose stendën e informimit data dhe ora e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak për periudhën Janar 2020-Shkurt 2021? Nëse po, më përcillni kopje të njoftimit/njoftimeve për zhvillimin e këtyre mbledhjeve, kur dhe ku është publikuar njoftimi/njoftimet, kopje të procesverbaleve të mbajtura dhe dokumente të tjera që mbështesin realizimin e këtij procesi.

5 A janë njoftuar paraprakisht në faqen e internetit ose stendën e informimit data dhe ora e mbledhjeve të Komisioneve të Këshillit Bashkiak



për periudhën Janar 2020-Shkurt 2021? Nëse po, më përcillni kopje të njoftimit/njoftimeve për zhvillimin e këtyre mbledhjeve, kur dhe ku është publikuar njoftimi/njoftimet, kopje të procesverbaleve të mbajtura dhe dokumente të tjera që mbështesin realizimin e këtij procesi.

- 6** A shfaqen në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike, njoftime për organizimin e Dëgjesave Publike nga Këshilli Bashkiak për periudhën Janar 2020-Shkurt 2021? Nëse po, më përcillni kopje të njoftimit/njoftimeve për zhvillimin e këtyre dëgjesave, kur dhe ku është publikuar njoftimi/njoftimet, kopje të procesverbaleve të mbajtura dhe dokumente të tjera që mbështesin realizimin e këtij procesi.
- 7** A ka qenë Bashkia juaj ndonjëherë përfituese e Fondit Social që nga krijimi i tij dhe nëse po, sa ka qenë periudha për të cilën është ofruar mbështetje dhe në çfarë vlere monetare?

Në bazë të nenit 3, të ligjit Nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" ku parashikohet "**Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet**

dokumentit original ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentit, kërkoj dokumentacionin përkatës që mbështet realizimin e procesve të referuar në pyetjet e mësipërme.

Në bazë të nenit 15, të ligjit Nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" ku parashikohet "**Autoriteti publik trajton kërkesën për informim, duke parashtruar informacionin e kërkuar sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se 10 ditë pune nga dita e dorëzimit të saj, përveç rasteve kur ligji i posaçëm parashikon ndryshe**" lutem përcjelljen e informacionit dhe dokumentacionit përkatës brenda këtij afati ligjor.

Për çdo komunikim tjetër për sqarimin e kërkesës së paraqitur, mund të më kontaktoni edhe në emailin: **email: emermbiemer@email.com**

Duke ju falenderuar,

Emër Mbiemër

Ky raport u mbështet nga National Endowment Democracy (NED)

Raporti u punua nga:

Enkelejd Musabelliu dhe Erisa Proko dhe Elira Canga

